



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 dhjetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Korrigjuar i Vendimit të Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave  
Jogjore të Prokurorit të Specializuar**

---

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues ftoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të paraqiste mocion për praninë të provave jогоjore në lidhje me: (i) provat materiale të propozuara në listën e vet të provave materiale që synon t'i përdorë për cilindo prej 40 dëshmitarëve të parë të saj; dhe (ii) materialin provues që ZPS-ja e gjykon të rëndësishëm për paraqitjen sa më të qartë e të efektshme të argumenteve të veta në këtë fazë të procesit ("Urdhri i Katërt Gojor").<sup>1</sup>
2. Më 8 shkurt 2023, ZPS-ja paraqiti kërkesën për praninë e materialeve si prova jогоjore ("Mocioni i Provave Jогоjore").<sup>2</sup>
3. Më 21 shkurt 2023, pas kërkesës së ekipeve të mbrojtjes të Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") ("të akuzuarit" dhe "Mbrojtja"), Trupi Gjykues zgjati afatin për përgjigje ndaj Mocionit të Provave Jогоjore deri më 21 mars 2023.<sup>3</sup>
4. Më 21 mars 2023, Mbrojtja u përgjigj ndaj Mocionit të Provave Jогоjore ("Përgjigja").<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Transkripti i seancës, Trupi Gjykues, 16 dhjetor 2022, f. 1775, rreshti 6 deri f. 1776, rreshti 5.

<sup>2</sup> F01268, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Praninë e Provave Jогоjore*, 8 shkurt 2023, me Shtojcat 1-4, 6, 7, konfidenciale, dhe me Shtojcat 5, 8.

<sup>3</sup> F01309, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jогоjore dhe Pezullim e Zgjatje Afati*, 21 shkurt 2023, para. 15, 16(c).

<sup>4</sup> F01387, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Praninë e Provave Jогоjore*, 21 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-8, konfidenciale.

5. Më 23 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë në të cilën korrigjoi gabimet në lidhje me dy dokumente të parashtruara në Mocionin e Provave Jogojore (“Njoftimi”).<sup>5</sup>

6. Më 31 mars, 9 qershor, 27 korrik, 8 gusht dhe 3 tetor 2023, Trupi Gjykses lëshoi vendime në të cilat shqyrtoi pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore (përkatësisht, “Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore”, “Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore”, “Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Provave Jogojore”, “Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Provave Jogojore” dhe “Vendimi i Pestë mbi Mocionin e Provave Jogojore”).<sup>6</sup>

## II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të materialeve të ndara në gjashtë kategori: (i) komunikata, deklaratat politike dhe njoftime të tjera të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”); (ii) versione jopërfundimtare të deklaratave publike të UÇK-së, që iu sekuestruan z. Krasniqi; (iii) arkiva të botuara të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, *Radio Kosova e Lirë* (“RKL”); (iv) arkiva të botuara të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, *Kosovapress*; (v) ribotime të materialit të agjencisë së lajmeve *Kosovapress* në media të tjera; dhe (vi) materiale të tjera që nuk mund të ndahen në kategori konkrete, por përfshihen në kuadrin e Urdhrit të Katërt Gojor të Trupit Gjykses.<sup>7</sup>

---

<sup>5</sup> F01393, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë në lidhje me Dy Materiale të Parashtruara si Prova Jogojore*, 23 mars 2023, konfidencial.

<sup>6</sup> F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial; F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023; F01705, Trupi Gjykses, *Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 27 korrik 2023; F01716, Trupi Gjykses, *Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 gusht 2023, konfidencial; F01832, Trupi Gjykses, *Vendimi i Pestë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 3 tetor 2023.

<sup>7</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 2.

8. Mbrojtja përgjigjet se Mocioni i Provave Jogojore është përpjekje e paarsyeshme dhe dëmtuese për të pranuar një vëllim të madh të provave duke shmangur kontrollin e drejtë dhe kriteret që dokumentet të vërtetohen dhe të verifikohen gjatë paraqitjes përmes dëshmitarëve përkatës.<sup>8</sup> Mbrojtja parashton se ZPS-ja nuk ka zbatuar udhëzimin e Trupit Gjykses për kriteret të rrepta të vlerësimit për të mundësuar paraqitjen e provave me vlerë të lartë.<sup>9</sup> Mbrojtja shton se kjo qasje do të krijojë dokumentacion gjyqësor të fryrë dhe do të dëmtojë drejtësinë e procesit duke devijuar ndjeshëm nga parimi udhërrëfyes i paraqitjes së dëshmimeve gojore, të seancave publike dhe ballafaqimit që as nuk do ta përshpejtojë as nuk do ta ndihmojë gjykimin e drejtë të çështjes.<sup>10</sup> Krahas kësaj, Mbrojtja kundërshton në përgjithësi pranimin si prova jogojore të 13 kategorive të ndryshme të provave dokumentare dhe paraqet kundërshtime konkrete të tjera ndaj një numri materiale. <sup>11</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me këtë pikë janë përcaktuar, në veçanti, në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në

---

<sup>8</sup> Përgjigjja, para. 1.

<sup>9</sup> Përgjigjja, para. 3.

<sup>10</sup> Përgjigjja, para. 4.

<sup>11</sup> Përgjigjja, para. 14-105. Shih në përgjithësi, F01387/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A02, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 2 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A03, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 3 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 3 e Përgjigjes"), 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A04, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 4 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 4 e Përgjigjes"), 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A05, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 5 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A06, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 6 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale.

Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore.<sup>12</sup> Trupi Gjykues do të zbatojë këto standarde në këtë vendim.

#### IV. DISKUTIM

##### A. ASPEKTE PARAPRAKE

10. Trupi Gjykues vë në dukje se, në vendimet e mëparshme në lidhje me Mocionin e Provave Jogojore, ai u dha përparësi: (i) materialeve që ZPS-ja kishte identifikuar se lidheshin me gjashtë dëshmitarët e parë; (ii) materialeve që ZPS-ja kishte identifikuar se lidheshin me gjashtë dëshmitarët pas tyre; (iii) Shtojcës 1 të Mocionit të Provave Jogojore; (iv) Shtojcave 3-5 të Mocionit të Provave Jogojore; dhe; (v) materialeve që pretendohet se janë sekuestruar, përkatësisht nga banesat e z. Selimi dhe z. Krasniqi. Ky vendim shqyrton materialet e mbetura në Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore.<sup>13</sup>

11. Pranimi i një numri materialesh që përmban Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore nuk duhet të shqyrtohet këtu. Për dhjetë prej këtyre materialeve tashmë është konstatuar se janë të përshtatshme për pranim sipas rregullës 154 në tërësi ose pjesërisht, si “prova materiale shoqëruese”.<sup>14</sup> Një pjesë e këtyre materialeve

---

<sup>12</sup> *Shih* Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 8-13.

<sup>13</sup> Trupi Gjykues vë në dukje se të gjitha referencat ndaj materialeve në Shtojcat e Mocionit të Provave Jogojore në këtë vendim përfshijnë përkthimet e tyre përkatëse (nëse ka) përveç nëse është thënë ndryshe.

<sup>14</sup> *Shih* F01901, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W03170-ës, W04043-shit, W04444-ës, W04571-shit, W04765-ës, W04811-shit, dhe W04870-ës sipas Rregullës 154 dhe Kërkesën lidhur me To*, 2 nëntor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01901/RED), para. 22, 68, 90(c) (ku konstatohet se SPOE00126370-00126370, SPOE00126373-00126373, f. SPOE00209329-SPOE00209332 e SPOE00209321-00209428, dhe pjesa 01:13-01:26 e 106389-01 janë të përshtatshëm për pranim; F01848, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W00208, W02082, W02475, W04147, W04325, W04491, dhe W04753 sipas Rregullës 154*, 10 tetor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 nëntor 2023, F01848/RED), para. 56, 67, 104(b) (ku konstatohet se 075413-075414, 075409-075412, 075395-075402, 075392-075394, 075382-075387, 075378-075381, 075349-075360, 075336-075348, 075316-075335, 075309-075315, dhe 075300-075308 janë të përshtatshëm për pranim); F01700, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave nga W03724, W03832, W03880, W04368, W04566, dhe*

tashmë janë pranuar si prova.<sup>15</sup> Për dy materiale është konstatuar se janë të papërshtatshme për pranim sipas rregullës 154.<sup>16</sup> Gjithashtu, 16 materiale janë pranuar si prova në sallë të gjyqit.<sup>17</sup> Për këto arsye, kërkesa për pranimin e këtyre materialeve si prova jोगojore është e tejkaluar.

12. Trupi Gjykues vë në dukje se 008348-008351 u paraqit si material i renditur në Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jोगojore me të njëjtin ERN, dhe u pranua më parë.<sup>18</sup> Rrjedhimisht, kërkesa për pranimin e këtij materiali përmes Shtojcës 6 të Mocionit të Provave Jोगojore është gjithashtu e tejkaluar.

---

W04769 sipas Rregullës 154 ("Vendimi i Katërt sipas Rregullës 154"), 24 korrik 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 7 nëntor 2023, F01700/RED), para. 60, 68, 92 (ku konstatohet se pjesa 0:00:00-00:05:07 e 054010-03, pjesa 00:04:55-00:05:07 e 011795-06, f. U007-9618 deri U007-9620 e U007-9607-U007-9661, U002-3339-U002-3340, U000-5851-U000-5851 dhe SITF00021875-SITF00021876 janë të përshtatshëm për pranim); F01664, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W00072-shit, W02153-shit dhe W04586-ës sipas Rregullës 154*, 10 korrik 2023, konfidencial, para. 34, 38 (ku konstatohet se f. U007-9617 e U007-9607-U007-9661 është e përshtatshme për pranim); F01595/COR, Trupi Gjykues, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Mocionin e Dytë të Prokurorisë sipas Rregullës 154*, 10 gusht 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 nëntor 2023, F01595/COR/RED), para. 50, 100(b) (ku konstatohet se f. 074666-074675 të 074666-074681 janë të përshtatshme për pranim); Transkripti i seancës, Trupi Gjykues, 25 shtator 2023, f. 8203 (duke pranuar faqet 074666, 074667, 074668, 074669, 074671 dhe 074672 të 074666-074681 si P0412); F01380, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154* ("Vendimi i Parë sipas Rregullës 154"), 16 mars 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 7 nëntor 2023, F01380/RED), para. 92, 95 (ku konstatohet se SPOE0033039-00330391 dhe IT-05-87.P00456 janë të përshtatshëm për pranim përmes rregullës 154).

<sup>15</sup> F. U007-9617 e U007-9607-U007-9661 u pranuan si provë si P00236 më 18 korrik 2023.

<sup>16</sup> Vendimi i Parë sipas Rregullës 154, para. 39, 52, 56, 92 (ku konstatohet se 067269-067710 dhe SPOE00198098-00198366 janë të papërshtatshme për pranim).

<sup>17</sup> U000-4847-U000-4852 (u pranua si P00074 më 11 maj 2023); SPOE00330390-00330391 (u pranua si 1D0007 më 20 prill 2023); f. SPOE00209330 e SPOE00209321-00209428 (u pranua si P00509 më 11 tetor 2023); SITF00242581-00242581 (u pranua si P00226 më 12 korrik 2023); SPOE00056149-00056200 (u pranua si P00201 më 20 qershor 2023); SITF00437785-00437792 (u pranua si P00067 më 10 maj 2023); IT-05-87.1 P00446 (u pranua si P00228 më 13 korrik 2023); SITF00069018-SITF00069021 (u pranua si P00225 më 12 korrik 2023); SPOE00119161-00119161 (u pranua si 1D00029 më 14 korrik 2023); 069758-01 (u pranua si P00323 më 28 gusht 2023); 061427-12 (u pranua si P00093 më 22 maj 2023); 050084-01 (u pranua si P00088 më 11 maj 2023); 034172-034173 (u pranua si P00320 më 28 gusht 2023); 034157-034158 (u pranua si P00319 më 28 gusht 2023); 011795-06 (pjesa 00:04:55-00:05:07 e pranuar si P00502 më 11 tetor 2023); 034155-034155 (u pranua si P00683 më 7 nëntor 2023); *shih gjithashtu Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jोगojore, materialet 170, 203, 332 (pjesërisht), 369, 394, 419, 452, 469, 491, 564, 602, 624, 633, 639, 641, 649 (pjesërisht).*

<sup>18</sup> *Krahaso Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jोगojore, materiali 653 me F01268/A03, Prokurori i Specializuar, Shtojca 3 e Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jोगojore, 8 shkurt 2023,*

13. Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje se një material është dublikatë i dokumenteve të tjera të paraqitura në Mocionin e Provave Jogojore.<sup>19</sup> Trupi Gjykues e ka të paqartë pse duhet të pranohet më shumë se një kopje e të njëjtit dokument. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues refuzon në formë jo të prerë pranimin si provë të SITF00242579-00242579.<sup>20</sup>

14. Trupi Gjykues nuk do të shqyrtojë pranimin e dy dokumenteve në këtë fazë për të cilat ZPS-ja nuk ka paraqitur përkthime përkatëse as në shqipe, as në anglishte.<sup>21</sup> ZPS-ja nuk i ka paraqitur as versionet e plota në anglishte të nëntë raporteve të veçanta lidhur me kufoma,<sup>22</sup> të librit “Kështu e bëmë luftën” me autor Xhavit Halitin,<sup>23</sup> dhe të dokumenteve dhe pjesëve nga gazetatat që kanë të bëjnë me një deklaratë të mëparshme të W04644-ës.<sup>24</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues refuzon në mënyrë jo të prerë pranimin e U009-1596-U009-1662, SITF00069180-SITF00069180, R111-7289-R111-7291-AT, R111-7286-R111-7288-AT, R111-7282-R111-7285-AT, R111-7278-R111-7281-AT, R111-7275-R111-7277-AT, R111-7271-R111-7274-AT, R111-7267-R111-7270-AT, R111-7264-R111-7266-AT, R111-7258-R111-7263-AT, SITF00245017-00245111 dhe f. 074675A-074681 të 074666-074681.

---

konfidenciale, materiali 102; *Shih gjithashtu* Vendimin e Katërt mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 50(c).

<sup>19</sup> Trupi Gjykues vë në dukje se një faqe në SITF00242579-00242579 dublohet në SITF00069018-SITF00069021, që u pranua në sallën e gjyqit si P00225 më 12 korrik 2023; *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 454, 469.

<sup>20</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 454.

<sup>21</sup> U009-1596-U009-1662 (ekziston vetëm përkthimi i pjesshëm në anglishte), SITF00069180-SITF00069180; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 34, 467.

<sup>22</sup> R111-7289-R111-7291-AT, R111-7286-R111-7288-AT, R111-7282-R111-7285-AT, R111-7278-R111-7281-AT, R111-7275-R111-7277-AT, R111-7271-R111-7274-AT, R111-7267-R111-7270-AT, R111-7264-R111-7266-AT, R111-7258-R111-7263-AT; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 478-486.

<sup>23</sup> SITF00245017-00245111; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 434.

<sup>24</sup> *Shih* 074666-074681, f. 074670, 074673-074681; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 563. Shënim: u konstatua se faqet 074666-074675 ishin të përshtatshme për pranim përmes rregullës 154, dhe faqet 074666, 074667, 074668, 074669, 074671 dhe 074672 u pranuan si P0412, siç pasqyrohet në para. 11, poshtëshënimi 14.

## B. KATEGORITË E PROVAVE TË PROPOZUARA

15. Trupi Gjykses tani do të shqyrtojë kërkesat e ZPS-së për pranimin e materialeve të mbetura që përmban Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore. Trupi Gjykses i ka vlerësuar këto materiale në kontekst të kategorive në vijim: (i) fotografi dhe video; (ii) libra; (iii) artikuj nga gazetat; (iv) dokumente zyrtare nga organizatat; (v) dokumente të lidhura me UÇK-në; dhe (vi) dokumente nga procese gjyqësore shtetërore dhe ndërkombëtare.

### 1. Kategoria 1: Fotografi dhe video

16. ZPS-ja kërkon pranimin e nëntë fotografive<sup>25</sup> dhe 12 videove.<sup>26</sup> ZPS-ja parashtron se këto fotografi dhe video kanë lidhje me lëndën, janë autentike, kanë vlerë provuese dhe se vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>27</sup> ZPS-ja parashtron se lidhja me lëndën dhe vlera provuese e fotografive bazohet në faktin se në to shihen vende konkrete të krimeve<sup>28</sup> dhe marrëdhënia e ngushtë midis z. Thaçi, z. Veseli dhe anëtarëve të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët të pretenduar.<sup>29</sup> ZPS-ja parashtron se lidhja me lëndën e videove bazohet në faktin se në to gjithashtu shihen vende konkrete të krimit,<sup>30</sup> kanë përmbajta që lidhet me format e përgjegjesisë,<sup>31</sup> ose të dyja.<sup>32</sup>

---

<sup>25</sup> U003-2456-U003-2458, U002-4992-U002-4995, SPOE00113615-00113639, SPOE00072818-SPOE00072818, SPOE00072817-SPOE00072817, SPOE00072816-SPOE00072816, SPOE00072810-SPOE00072810, IT-03-66 P1.9, 058755-058755; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 50, 51, 373, 378, 379, 380, 381, 523, 613.

<sup>26</sup> IT-03-66 P34, 106389-01, 077571-01, 061427-30, 061427-17, 061427-16, 061427-11, 061427-05, 061427-04, 055928-01, 054010-03, 011795-06; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 509, 524, 543, 593, 596, 599, 604, 607, 610, 618, 623, 649.

<sup>27</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>28</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 50, 51, 373, 378, 379, 380, 381, 523.

<sup>29</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 613.

<sup>30</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 509, 524, 543, 618, 623, 649.

<sup>31</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 593, 596, 599, 607, 610.

<sup>32</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 604.

17. Mbrojtja kundërshton pranimin e fotografive dhe videove të shumta si prova jogojore sepse shumica janë bërë ose kanë lidhje me dëshmitarë të ZPS-së dhe, rrjedhimisht, duhet të paraqiten përmes këtyre dëshmitarëve.<sup>33</sup> Mbrojtja parashtron se jurisprudenca e krijuar përcakton se fotografitë dhe videot nuk duhet të pranohen si prova jogojore në mungesë të provave shtesë në lidhje me përmbajtjen e tyre dhe rrethanat në të cilat janë marrë ose incizuar.<sup>34</sup>

(a) Fotografitë

18. Sa i përket lidhjes me lëndën dhe vlerës provuese, Trupi Gjykses gjykon se, edhe pse ZPS-ja parashtron se në fotografitë shihen vende relevante, kjo nuk është e vetëkuptueshme nga përmbajtja tyre dhe pa kontekst të mëtejshëm. Dëshmitë e dëshmitarëve ku thuhet se fotografitë janë pamje të drejta dhe të sakta të vendeve të përmendura janë të domosdoshme për të përcaktuar lidhjen e tyre me lëndën. Edhe pse fotografia e z. Thaçi, z. Veseli dhe anëtarëve të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët të pretenduar pretendohet se demonstroi marrëdhëniet e ngushta midis tyre, konteksti në të cilin është bërë kjo fotografi është i domosdoshëm për të përcaktuar drejtë lidhjen e saj me lëndën. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon në mënyrë jo të prerë pranimin si prova jogojore të U003-2456-U003-2458, U002-4992-U002-4995, SPOE00113615-00113639, SPOE00072818-SPOE00072818, SPOE00072817-SPOE00072817, SPOE00072816-SPOE00072816, SPOE00072810-SPOE00072810, IT-03-66 P1.9 dhe 058755-058755.

(b) Videot

---

<sup>33</sup> Përgjigja, para. 95.

<sup>34</sup> Përgjigja, para. 95-96; Shtojca 6.8 e Përgjigjes, f. 2-3, 7-8, 34, 36.

19. Sa i përket lidhjes me lëndën, videot duket se tregojnë ngjarje në lidhje me krimet në aktakuzë, përfshirë negociatat për pengjet që ndodhën në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës. Videot janë relevante për sugjerimin se anëtarë të UÇK-së morën peng civilë dhe për sugjerimin e mëtejshëm të një politike organizative në të cilat bazoheshin këto veprime.

20. Sa i përket autenticitetit, asgjë në videot nuk tregon se në to shihen ngjarje përveç atyre që pretendohet se janë incizuar, ose se janë manipuluar në ndonjë mënyrë. Gjithashtu, autenticiteti i një numri të këtyre videove konfirmohet nga provat që tashmë janë përfshirë në dokumentacionin e çështjes.<sup>35</sup> Trupi Gjykses konstaton se është përmbushur kriteri i autenticitetit *prima facie*.

21. Sa i përket vlerës provuese të tyre, përmbajtja e videove ofron informacion në lidhje me, ndër të tjera, organizimin dhe strukturën e forcave të UÇK-së gjatë periudhës së Aktakuzës,<sup>36</sup> ndalimin dhe lirimin e të ndaluarve nga UÇK-ja,<sup>37</sup> dhe politikat për media të UÇK-së.<sup>38</sup> Dokumentet 061427-05 dhe 055928-01 konfirmohen deri në njëfarë mase nga dëshmia e W03880-ës<sup>39</sup> si dhe nga videoja që iu tregua W03880-ës gjatë dëshmisë.<sup>40</sup>

22. Gjatë shqyrtimit nëse vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre, Trupi Gjykses vë në dukje se disa nga videot përmbajnë dëshmi të dorës së dytë. Megjithatë, kjo nuk i bën ato të papranueshme dhe do të merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së këtyre dëshmive, nëse kanë. Trupi Gjykses vë në dukje më tutje se përmbajtja e atyre videove mund të jetë objekt i marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës. Së fundi, Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja nuk tregoi asnjë aspekt të atyre videove që pranimi i tyre do të

---

<sup>35</sup> Për shembull, *krahaso* P00093 me 061427-05 dhe 055928-01; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 607, 618.

<sup>36</sup> *Shih* IT-03-66 P34, 077571-01, 061427-17, 061427-16, 061427-04.

<sup>37</sup> *Shih* 106389-01; 011795-06.

<sup>38</sup> *Shih* 061427-11.

<sup>39</sup> Transkripti i seancës, Trupi Gjykses, 9 tetor 2023, f. 8472-8474.

<sup>40</sup> *Shih* 061427-12, i pranuar si P00093 më 22 maj 2023.

shkaktonte padrejtësisht dëm të papërligjur. Rrjedhimisht, vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

23. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova jогоjore IT-03-66 P34, 106389-01 nga 00:00 to 01:12 deri 01:27 deri 02:00, 077571-01, 061427-30, 061427-17, 061427-16, 061427-11, 061427-05, 061427-04, 055928-01, 054010-03, nga 00:05:08 deri 35:54,<sup>41</sup> dhe 011795-06 nga 00:00:01 deri 00:04:54 dhe nga 00:05:08 deri 00:15:00,<sup>42</sup>.

## 2. Kategoria 2: Librat

24. ZPS-ja kërkon pranimin e pesë librave, në tërësi dhe/ose pjesërisht. Titujt e këtyre librave janë “Libri i Luftës”,<sup>43</sup> “Kështu e bëmë luftën”,<sup>44</sup> “Lëvizja: Lindje në Gjak”,<sup>45</sup> “Flakë e Pashuar”,<sup>46</sup> “Ne Ishim e Ardhmja”,<sup>47</sup> dhe “Lufta e UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes”.<sup>48</sup> ZPS-ja parashtron se këto materiale kanë lidhje me lëndën, janë autentike, kanë vlerë provuese dhe se vlera e tyre provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>49</sup>

25. Mbrojtja kundërshton pranimin e librave si prova jогоjore.<sup>50</sup> Mbrojtja parashtron se nuk mund të mbështetesh në librat e paraqitur sepse janë në masë të madhe të bazuara në informacion të dorës së dytë të marrë nga palë të treta që nuk mund të merren në pyetje drejtpërdrejt nga Mbrojtja.<sup>51</sup> Mbrojtja shton se ZPS-

---

<sup>41</sup> *Shih* Vendimin e Katërt sipas Rregullës 154, para. 60 (ku konstatohet se pjesa 0:00:00-00:05:07 e 054010-03 është e përshtatshme për pranim); *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimin 14.

<sup>42</sup> *Shih* Vendimin e Katërt sipas Rregullës 154, para. 60 (ku konstatohet se pjesa 00:04:54 to 00:05:07 e 011795-06 është e përshtatshme për pranim); *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimin 14.

<sup>43</sup> SPOE00128571-00128954; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materialet 336-360.

<sup>44</sup> SITF00245022-SITF00245096; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 435.

<sup>45</sup> 076891-076903; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 546.

<sup>46</sup> 043900-044239; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 625.

<sup>47</sup> SPOE00209321-00209428; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 332. *Shih* poshtëshënimin 17 më lart, ku vihet në dukje se f. SPOE00209330 tashmë ishte pranuar si provë si P00509 gjatë procesit gjyqësor më 11 tetor 2023, dhe, rrjedhimisht, nuk do të shqyrtohet këtu.

<sup>48</sup> 036622-036837; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materiali 632.

<sup>49</sup> Mocioni i Provave Jогоjore, para. 3.

<sup>50</sup> Përgjigjja, para. 68; Shtojca 6.4 e Përgjigjes, f. 1-16.

<sup>51</sup> Përgjigjja, para. 69.

ja nuk ka treguar qartë se ku dhe si librat e ndryshëm përputhen me argumentet e veta dhe se ZPS-ja kërkon të paraqesë libra të gjatë pa identifikuar pjesët relevante të tyre.<sup>52</sup>

26. Trupi Gjykes urdhëroi në Urdhrin për Zhvillimin e Gjykimit që:

Sa u përket dokumenteve të gjata ose librave, ku vetëm një pjesë ka lidhje me lëndën ose ku pala mbështetet vetëm në një pjesë, pala që paraqet materialin bën të ditur, në gjuhën origjinale dhe në anglishte, faqet e dokumentit që kërkon të pranohen si prova. Nëse i gjithë dokumenti paraqitet si provë, pala tenton po ashtu të identifikojë, për aq sa është e mundur, pjesët e dokumentit në të cilin kërkon të mbështesë argumentet e saj.<sup>53</sup>

27. Trupi Gjykes vë në dukje se “Libri i Luftës” ishte shqyrtuar për pranim nga Trupi Gjykes në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore.<sup>54</sup> Në atë vendim, Trupi Gjykes vuri në dukje se autori, W04410, është dëshmitar i propozuar nga ZPS-ja,<sup>55</sup> dhe konstatoi se do të ishte e parakohshme të pranohet libri para se të dëgjohej autori.<sup>56</sup> Trupi Gjykes merr të njëjtin qëndrim sa i përket pjesëve të veçanta të librit “Libri i Luftës”<sup>57</sup> që është paraqitur nga ZPS-ja përmes Shtojcës 6, dhe refuzon në këtë moment, në mënyrë jo të prerë, pranimin e pjesëve si prova jogojore.

<sup>52</sup> Përgjigja, para. 70.

<sup>53</sup> F01226/A01, Trupi Gjykes, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 50.

<sup>54</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 19.

<sup>55</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 19 (*duke cituar F01296/A02, Prokurori i Specializuar, Shtojca 2 e Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me Vendimin F01229, 15 shkurt 2023, konfidenciale, f. 12*).

<sup>56</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 19, 26, 180(d).

<sup>57</sup> SPOE00128614-SPOE00128614, SPOE00128617-SPOE00128631, SPOE00128632-SPOE00128636, SPOE00128636-SPOE00128637, SPOE00128640-SPOE00128647, SPOE00128649-SPOE00128660, SPOE00128665-SPOE00128669, SPOE00128670-SPOE00128677, SPOE00128684-SPOE00128693, SPOE00128699-SPOE00128700, SPOE00128702-SPOE00128703, SPOE00128740-SPOE00128743, SPOE00128746-SPOE00128751, SPOE00128754-SPOE00128755, SPOE00128758-SPOE00128767, SPOE00128770-SPOE00128776, SPOE00128778-SPOE00128785, SPOE00128785-SPOE00128850, SPOE00128903-SPOE00128905, SPOE00128906-SPOE00128908, SPOE00128909-SPOE00128911, SPOE00128912-SPOE00128912, SPOE00128913-SPOE00128914, SPOE00128927-SPOE00128929; *shih Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 337-360*.

28. Dy librat e tjerë të paraqitur nga ZPS-ja, “Flakë e Pashuar”<sup>58</sup> dhe “Lufta e UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes”,<sup>59</sup> i shkroi dëshmitari i ZPS-së W04576, i cili ende nuk ka dhënë dëshmi.<sup>60</sup> “Ne ishim e Ardhmja”<sup>61</sup> e shkroi W04765, i cili gjithashtu është planifikuar të dëshmojë.<sup>62</sup> Për të njëjtat arsye të dhëna më lart, Trupi Gjykses refuzon në këtë moment pranimin e këtyre librave, në mënyrë jo të prerë<sup>63</sup>.

29. Sa i përket lidhjes me lëndën të “Kështu e bëmë luftën”<sup>64</sup> dhe “Lëvizja: Lindje në Gjak”,<sup>65</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se fokusi qendror i të dy librave është aktiviteti i UÇK-së në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës. Trupi Gjykses konstaton se këto dy libra janë relevantë për organizimin, strukturën dhe autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, zbatimin e politikave të UÇK-së, funksionimin e përgjithshëm të UÇK-së, organizimin e saj, dhe aftësitë operative në zona të veçanta operative.<sup>66</sup>

30. Sa i përket autenticitetit, secili libër përmban hollësi në lidhje me autorësinë dhe botimin. Trupi Gjykses është bindur se secili material është autentik *prima facie*.

---

<sup>58</sup> 043900-044239; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 625.

<sup>59</sup> 036622-036837; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 632.

<sup>60</sup> F01296/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me Vendimin F01229* (“Lista e Dëshmitarëve me më pak Redaktime”), 15 shkurt 2023, konfidenciale, f. 13.

<sup>61</sup> SPOE00209321-00209428; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 332.

<sup>62</sup> Lista e Dëshmitarëve me më pak Redaktime, f. 16, rreshti 274.

<sup>63</sup> Sa i përket SPOE00209321-00209428, Trupi Gjykses refuzon f. SPOE00209321-SPOE00209328 dhe SPOE00209333-SPOE00209428 sepse f. SPOE00209330 tashmë është pranuar si P00509 dhe f. SPOE00209329-SPOE00209332 është konstatuar se janë të përshtatshme për praninë në përputhje me rregullën 154; *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimet 14, 17.

<sup>64</sup> SITF00245022-SITF00245096; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 435.

<sup>65</sup> 076891-076903; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 546-549.

<sup>66</sup> F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar* (“Aktakuza e Ndryshuar”), 30 shtator 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00999/A03) (versionet me më pak redaktime u dorëzuan më 15 shkurt 2023 dhe 27 shkurt 2023, F01296/A03 dhe F01323/A01), para. 19, 37, 80.

31. Sa i përket vlerës provuese, siç thuhet më lart, fokusi qendror i këtyre librave dhe pjesëve shoqëruese janë aktivitetet e UÇK-së në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës. Ato trajtojnë organizimin, strukturën dhe autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, zbatimin e politikave të UÇK-së, si dhe aktivitetet e UÇK-së në zona të veçanta operative.<sup>67</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk e respektoi në tërësi urdhrin në paragrafin 50 të Urdhrit për Zhvillimin e Gjykimit sepse nuk u përpoq të identifikojë ato pjesë të librave në të cilat kërkon të mbështetet për qëllime të argumenteve të veta. Megjithatë, përkundër faktit se disa pjesë të librave duket se kanë pak ose aspak lidhje me lëndën, Trupi Gjykses konstaton se ato përmbajnë informacion me rëndësi për këtë proces, kanë vlerë provuese *prima facie* të mjaftueshme për të përlegjur pranimin e tyre.

32. Vlera provuese *prima facie* e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues që rezulton nga fakti se një pjesë e informacionit që përmbajnë ato është i llojit dytësor. Siç është vënë në dukje në mënyrë të përsëritur, lloji dytësor i këtyre dëshmimeve do të merret parasysh gjatë vlerësimit. Gjithashtu, Mbrojtja do të jetë në gjendje t'u bëjë pyetje dëshmitarëve përkatës për pjesë të këtyre librave me të cilat nuk pajtohet. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve të propozuara nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

33. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon SITF00245022-SITF00245096 dhe 076891-076903 dhe refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e SPOE00128614-SPOE00128614, SPOE00128617-SPOE00128631, SPOE00128632-SPOE00128637, SPOE00128640-SPOE00128647, SPOE00128649-SPOE00128660, SPOE00128665-SPOE00128669, SPOE00128670-SPOE00128677, SPOE00128684-SPOE00128693, SPOE00128699-SPOE00128700, SPOE00128702-SPOE00128703, SPOE00128740-SPOE00128743, SPOE00128746-SPOE00128751, SPOE00128754-SPOE00128755, SPOE00128758-SPOE00128767, SPOE00128770-SPOE00128776, SPOE00128778-SPOE00128785, SPOE00128785-SPOE00128850, SPOE00128903-

---

<sup>67</sup>Aktakuza e Ndryshuar, para. 19, 37, 80.

SPOE00128914, SPOE00128927-SPOE00128929, SPOE00209321-SPOE00209328, SPOE00209333-SPOE00209428, 036622-036837 dhe 043900-044239.

### 3. Kategoria 3: Artikujt e gazetave

34. ZPS-ja kërkon pranimin e artikujve që së pari u botuan në *Zëri i Kosovës*,<sup>68</sup> *Kosovapress*,<sup>69</sup> *Zikpress*,<sup>70</sup> *Bota Sot*,<sup>71</sup> *Informatori*,<sup>72</sup> *Rojters*,<sup>73</sup> *Dnevnik*,<sup>74</sup> *Uashington Post*,<sup>75</sup> dhe artikuj të përzgjedhur me përmbajtje nga media të ndryshme.<sup>76</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike, kanë vlerë provuese dhe se vlera e tyre provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>77</sup>

35. Mbrojtja përgjigjet se këto materiale përmbajnë dëshmi të dorës së dytë, pranimi i të cilave do të ishte padrejtësisht dëmtues, Mbrojtja nuk do të jetë në gjendje të kundërshtojë rrethanat në të cilat u bënë deklaratat apo të vë në dyshim besueshmërinë e tyre.<sup>78</sup> Mbrojtja gjithashtu parashtron se këto dokumente nuk përmbajnë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit<sup>79</sup> dhe nuk provojnë apo rrëzojnë aspekte që lidhen me lëndën, dhe për këtë arsye nuk kanë as relevancë e as vlerë provuese.<sup>80</sup> Së fundi, Mbrojtja parashtron se nuk mund të mbështetesh në përmbajtjen e këtyre materialeve sepse këto deklaratat jashtëgjyqësore nuk u dhanë për qëllime të procedurave gjyqësore; përkundrazi, qëllimi i tyre mund të ketë

<sup>68</sup> U016-3286-U016-3287, SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SITF00243000-00243003, 099794-099797, 043863-043863, 043853-043854; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 7, 195, 197, 199, 442, 528, 628, 630.

<sup>69</sup> 099786-099788; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 530.

<sup>70</sup> SPOE40000795-40000795; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 201.

<sup>71</sup> 034162-034162A; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 635.

<sup>72</sup> 034159-034159; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 637.

<sup>73</sup> 020396-020396; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 646.

<sup>74</sup> IT-03-66 P47; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 505.

<sup>75</sup> 021049-021056; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 645.

<sup>76</sup> 074666-074681; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 563.

<sup>77</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>78</sup> Përgjigja, para. 59.

<sup>79</sup> Shtojca 3 e Përgjigjes, materiali 1; Shtojca 4 e Përgjigjes, materiali 1.

<sup>80</sup> Shtojca 3 e Përgjigjes, materiali 1; Shtojca 4 e Përgjigjes, materiali 1.

qenë ngritja e moralit, sigurimi i përkrahjes ndërkombëtare, qetësimi i popullatës civile, apo promovimi i vetvetes.<sup>81</sup>

36. Sa i përket lidhjes me lëndën, materialet trajtojnë, ndër të tjera, faktet, aspektet dhe rrethanat në vijim që janë relevante në këtë çështje: (i) komandën, kontrollin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;<sup>82</sup> (ii) ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe elementet përbërëse të këtij konflikti;<sup>83</sup> dhe (iii) krimet që pretendohet se janë kryer në Shalë,<sup>84</sup> Likoc,<sup>85</sup> Qirez<sup>86</sup> dhe Baicë, si relevante për akuzat.<sup>87</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se këta artikuj të gazetave kanë lidhje me lëndën.

37. Faktorët relevantë për përcaktimin e autenticitetit *prima facie* të lajmeve në shtyp, artikujve të gazetave dhe intervistave përfshijnë, ndër të tjera, tregues për prejardhjen e materialit, datën e botimit, emrin e agjencisë së shtypit, përmbajtjen e materialit, dhe/ose emrin e autorit (nëse artikulli ose deklarata për shtyp ka autor).<sup>88</sup> Edhe pse fakti që autori i dokumentit nuk mund të identifikohet ose informacioni që përmban ai nuk ka burim, kjo nuk do të thotë se e përjashton atë për pranim, por mund të ndikojë në peshën që i jep Trupi Gjykses.<sup>89</sup> Trupi Gjykses

---

<sup>81</sup> Përgjigjja, para. 60.

<sup>82</sup> *Shih p.sh.* U016-3286-U016-3287, SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SITF00243000-00243003, 043853-043854; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 7, 195, 197, 199, 442, 630.

<sup>83</sup> *Shih p.sh.* 099794-099797, 043863-043863; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 528, 628.

<sup>84</sup> 034162-034162A; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 635.

<sup>85</sup> 074666-074681; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 563.

<sup>86</sup> 034159-034159; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 637.

<sup>87</sup> 034159-034159; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 637.

<sup>88</sup> KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjykses II, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 31-35, 39-41; Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ"), *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, [Decision on Defence's Fifth Motion for the Admission of Documents from the Bar Table](#), 30 May 2016, paras 13-15; *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Documents from the Bar Table \(Military and Residual Documents\)](#), 13 February 2014, para. 16.

<sup>89</sup> International Criminal Court, *Prosecutor v Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-2721, Trial Chamber III, [Decision on the Admission into Evidence of Items Deferred in the Chamber's Decision on the Prosecution's](#)

vë në dukje se, për shumicën e materialeve që shqyrtohen, burimi i lajmit, autori, dhe/ose data e artikullit identifikohen lehtë.<sup>90</sup> Gjithashtu, çdo material që ka këto elemente identifikuese është dorëzuar edhe si skanim i origjinalit të shtypur<sup>91</sup> ose si version i shtypur i botimit në internet, duke mbështetur më tutje autenticitetin e tyre.<sup>92</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të këtyre materialeve.<sup>93</sup>

38. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk ofroi tregues të qartë dhe të verifikueshëm për prejardhjen e disa provave materiale të propozuara. E para, Trupi Gjykses nuk ishte në gjendje të përcaktonte prejardhjen apo burimin e 099794-099797<sup>94</sup> dhe 099786-099788.<sup>95</sup> Është e paqartë nëse ndonjëri prej tyre vjen nga gazetatat e botuara apo burime të tjera.<sup>96</sup> Edhe pse U016-3286-U016-3287<sup>97</sup> është i shtypur në gazetë, gazeta, autori dhe data nuk mund të identifikohen qartë. IT-03-66 P47<sup>98</sup> duket se është raport i botuar në *Dnevnik* më 29 qershor 1998.<sup>99</sup> Autori nuk është identifikuar përveç se me iniciale të cilat nuk tregohet se kujt i përkasin. Aty nuk tregohet baza apo burimi i informacionit që jep. Trupi Gjykses konstaton

---

[Application for Admission of Materials into Evidence Pursuant to Article 64\(9\) of the Rome Statute” \(ICC-01/05-01/08-2299\)](#), 27 June 2013, para. 25.

<sup>90</sup>SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SPOE40000795-40000795, SITF00243000-00243003, 043863-043863, 043853-043854, 034162-034162A, 034159-034159, 021049-021056, 020396-020396; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 195, 197, 199, 201, 442, 628, 630, 635, 637, 645, 646.

<sup>91</sup> SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SPOE40000795-40000795, SITF00243000-00243003, 043863-043863, 043853-043854, 034162-034162A, 034159-034159; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 195, 197, 199, 201, 442, 628, 630, 635, 637.

<sup>92</sup> 021049-021056, 020396-020396; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 645, 646.

<sup>93</sup> SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SPOE40000795-40000795, SITF00243000-00243003, 043863-043863, 043853-043854, 034162-034162A, 034159-034159, 021049-021056, 020396-020396; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 195, 197, 199, 201, 442, 628, 630, 635, 637, 645, 646.

<sup>94</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 528.

<sup>95</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 530.

<sup>96</sup> 099794-099797, 099786-099788; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 528, 530.

<sup>97</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 7.

<sup>98</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 505.

<sup>99</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 505.

se ZPS-ja nuk ka përcaktuar mjaftueshëm qartë bazën në të cilën Trupi Gjykses mund të mbështetet për ta verifikuar autenticitetin *prima facie* të atyre materialeve.

39. Sa i përket materialeve autenticiteti i të cilave është përcaktuar në masë të mjaftueshme, siç është diskutuar më lart, Trupi Gjykses konstaton më tutje se secili prej tyre ka vlerë provuese *prima facie* në lidhje me aspektet e identifikuar më lart.<sup>100</sup>

40. Gjatë vlerësimit nëse vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre, Trupi Gjykses vë në dukje se afërsisht gjysma e artikujve të mbetur të gazetave që janë shqyrtuar kanë të bëjnë me dëshmitë e dëshmitarëve të ardhshëm. Tre prej tyre janë intervista të W01453-shit.<sup>101</sup> Një është intervistë me W04290-ën.<sup>102</sup> Një artikull i atribuon disa deklarata W04752-shit.<sup>103</sup> Një tjetër pretendohet se ka të bëjë me dëshmitë e W03827-ës, W03825-ës, dhe W03821-shit.<sup>104</sup> Mbrojtja do të jetë në gjendje të testojë ose kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve. Sa i përket artikujve që i atribuojnë deklarata UÇK-së apo cilitdo prej të akuzuarve,<sup>105</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se fakti që këto materiale janë dëshmi të llojit të dorës së dytë dhe çfarëdo kufizimi që kjo mund të shkaktojë për mundësinë e Mbrojtjes për të kundërshtuar përmbajtjen e këtyre dokumenteve do të merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së këtyre provave.<sup>106</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

---

<sup>100</sup> *Shih më lart*, para. 37.

<sup>101</sup> SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 195, 197, 199; *Shih gjithashtu* Listën e Dëshmitarëve me më pak Redaktime, f. 3, rreshti 40 (ku identifikohet W01453 si dëshmitar).

<sup>102</sup> 043853-043854; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 630; *Shih gjithashtu* Listën e Dëshmitarëve me më pak Redaktime, f. 9, rreshti 146 (ku identifikohet W04290 si dëshmitar).

<sup>103</sup> 020396-020396; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 646; *Shih gjithashtu* Listën e Dëshmitarëve me më pak Redaktime, f. 15, rreshti 267 (ku identifikohet W04752 si dëshmitar).

<sup>104</sup> 034159-034159; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 637.

<sup>105</sup> Përgjigjja, para. 59-60.

<sup>106</sup> Përgjigjja, para. 59.

41. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues pranon SPOE40000795-40000795, SPOE40010569-40010569, SPOE40010568-40010568, SPOE40010567-40010567, SITF00243000-00243003, 020396-020396, 021049-021056, 034159-034159, 034162-034162A, 043853-043854, dhe 043863-043863 si prova dhe refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e 099794-099797, 099786-099788, IT-03-66 P47 dhe U016-3286-U016-3287.

#### 4. Kategoria 4: Dokumentet zyrtare të organizatave

42. ZPS-ja kërkon të pranohen materialet që burojnë nga Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK),<sup>107</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ("OSBE"),<sup>108</sup> Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK"),<sup>109</sup> policia ushtarake gjermane që operonte si pjesë e Misionit të NATO-s në Kosovë ("KFOR"),<sup>110</sup> Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë,<sup>111</sup> Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Beograd<sup>112</sup> dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ("PSRK").<sup>113</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike, kanë vlerë provuese dhe se vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>114</sup>

43. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve përkatës.<sup>115</sup> Mbrojtja parashtron se raportet nga organizata

<sup>107</sup> U008-9781-U008-9974; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 36.

<sup>108</sup> U007-9607-U007-9661, SPOE00233999-00234000, SPOE00233700-00233701, SPOE00109507-00109518, SPOE00061164-00061168, SPOE00060952-00060954, SPOE00060865-00060865; SPOE00060777-00060785, SPOE00059723-00059725, IT-03-66 P46; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 41, 211, 212, 375, 384, 386, 387, 388, 389, 507.

<sup>109</sup> U007-9551-U007-9600, SPOE00073399-00073428, SPOE00068624-00068634, SITF00143980-00143983, IT-03-66 P111; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 42, 376, 382, 466.

<sup>110</sup> SITF00189121-00189140 RED2; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

<sup>111</sup> IT-03-66 P209; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 514.

<sup>112</sup> 102870-102875; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 525.

<sup>113</sup> 034163-034165; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 634.

<sup>114</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>115</sup> Përgjigjja, para. 86; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.6 të Përgjigjes, f. 14-15, 20-21, 26-27.

ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara ose organizata joqeveritare janë gjykuar në përgjithësi të papranueshme si prova jोगojore.<sup>116</sup> Mbrojtja pohon se: (i) ka të drejtë të kundërshtojë provat që përmbajnë raporte të tilla; (ii) në veçanti, sepse jepet pak ose aspak informacion se si është siguruar dokumenti apo për metodologjinë e mbledhjes së fakteve; (iii) raportet e tilla shpesh përmbajnë opinione ose përfundime për aspekte që janë kyçe për procesin, që mund të rezultojnë në mospërmbushjen nga Trupi Gjykses të funksionit të mbledhjes së fakteve; dhe (iv) kur raporte të tilla kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve, ose të anëtarëve të rrjetit të pretenduar, pranimi i tyre do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarit.<sup>117</sup>

(a) Raportet për personat e zhdukur

44. Raporti i KNKK-së për Personat e Zhdukur është relevant për statusin e katër viktimave të përmendura në Aktakuzën e Ndryshuar. Raporti i KNKK-së identifikon Nebojsa Gjuriçiqin, Velko Markoviçiqin, Rahim Elezin dhe Faik Recin si persona të zhdukur dhe jep kohën dhe vendin ku këto viktima ishin parë për herë të fundit.<sup>118</sup> ZPS-ja parashton se ky vëllim 194-faqësh është relevant në tërësi sepse tregon llojin e gjerë të krimeve të UÇK-së.<sup>119</sup> Raporti nuk i atribuon asnjë individ apo organizate veprimet që rezultuan në statusin e të zhdukurit të personave të përmendur.<sup>120</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se i tërë vëllimi është relevant për pretendimet se në atë kohë ekzistonin sulme të gjera dhe/ose sistematike kundër popullatës civile dhe praktika të sjelljes që mund të jenë

---

<sup>116</sup> Përgjigjja, para. 86-87.

<sup>117</sup> Përgjigjja, para. 87-89.

<sup>118</sup> U008-9781-U008-9974, f. U008-9795, U008-9796; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, titulli “Relevanca/Vlera provuese” për materialin 36. *Shih gjithashtu* Aktakuzën e Ndryshuar, para. 164, 166, Lista B, f. 63, rreshti 4, f. 65, rreshti 16.

<sup>119</sup> U008-9781-U008-9974; Tabela B titulli “Relevanca/Vlera provuese” për materialin 36.

<sup>120</sup> *Shih në përgjithësi* U008-9781-U008-9974; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, titulli “Relevanca/vlera provuese” për materialin 36.

relevante për disa nga konstatimet që duhet të nxjerrë Trupi Gjykses. Të dhënat e UNMIK-ut nga “baza e të dhënave e MPU-së /Njësia për Persona të Zhdukur - NJPZH/” për personat e zhdukur e vitit 2002 është e llojit të ngjashëm.<sup>121</sup> Ajo përmban të dhëna për viktimat Rahim Elezi dhe Nezir Topojani, i cili gjithashtu përmendet në Aktakuzën e Ndryshuar, dhe statusin e tyre si persona të zhdukur.<sup>122</sup> Ky material është gjithashtu relevant për rrethanat e krimeve kundër viktimave të përmendura me emër, si dhe për elementet kontekstuale të përmendura më lart.<sup>123</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se këto materiale janë relevante në tërësinë e tyre.

45. Trupi Gjykses kujton qasjen e vet ndaj autenticitetit dhe mbështetshmërisë së raporteve që burojnë nga organizatat ndërkombëtare, që është përcaktuar në Vendimin e Provave Jogojore.<sup>124</sup> Edhe dokumentet e KNKK-së edhe të UNMIK-ut përmbajnë shenja të autenticitetit, përfshirë stemat, vulat dhe/ose kreun e faqes të dokumenteve.<sup>125</sup> Trupi Gjykses gjykon se këto materiale janë autentike *prima facie*.

46. Të dhënat në këto materiale kanë vlerë provuese *prima facie*, sepse kanë të bëjnë me statusin e viktimave, datën e përafërt të zhdukjes së tyre, dhe vendin ku janë parë për herë të fundit. Ato gjithashtu kanë vlerë provuese për elementin kontekstual dhe praktikën e pretenduar të përmendur më lart.<sup>126</sup>

47. Siç është vënë në dukje më lart, zhdukja e personave të përmendur në këto dokumente nuk i atribuohet asnjë grupi apo personi. Kjo përforcon mendimin se vlera provuese *prima facie* e këtij materiali nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Gjithashtu, Trupi Gjykses mund të shqyrtojë faktin që autorët e këtyre

---

<sup>121</sup> SITF00143980-00143983; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 466.

<sup>122</sup> SITF00143980-00143983, f. SITF00143982, SITF00143983; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 466. *Shih gjithashtu* Aktakuzën e Ndryshuar, para. 166.

<sup>123</sup> *Shih në përgjithësi* SITF00143980-00143983; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 466.

<sup>124</sup> Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 43.

<sup>125</sup> *Shih* U008-9781-U008-9974, f. U008-9781, SITF00143980-00143983, f. SITF00143980; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 36, 466.

<sup>126</sup> *Shih më lart*, para. 44.

dokumenteve nuk do të paraqiten të dëshmojnë për t'i dhënë peshë përkatëse këtyre të dhënave pas mbylljes së çështjes. Trupi Gjykues konstaton se U008-9781-U008-9974 dhe SITF00143980-00143983 janë të pranueshme si prova jogojore.

(b) Raporti i policisë ushtarake të Gjermanisë (KFOR)

48. Të dhënat e policisë ushtarake gjermane, që vepronte si pjesë e KFOR-it, kanë të bëjnë me një bastisje të kryer në një objekt të UÇK-së në Prizren në qershor 1999.<sup>127</sup> Të dhënat tregojnë se persona u vranë, u torturuan, dhe u mbajtën në ndalim në atë objekt.<sup>128</sup> Këto dokumente janë relevante për akuzat e ZPS-së në Aktakuzën e Ndryshuar në lidhje me ngjarjet në Prizren në qershor 1999.<sup>129</sup>

49. Dokumentet përmbajnë tregues të autenticitetit, përfshirë stemat përkatëse, kreun në faqet e dokumenteve, nënshkrimet dhe formatin.<sup>130</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se dokumentet janë autentike *prima facie*.

50. Dokumentet kanë vlerë provuese *prima facie* sa u përket ngjarjeve dhe veprimeve të kryera në objektin e UÇK-së në kuadër të akuzave konkrete me të cilat ballafaqohen të akuzuarit, siç përmendet më lart. Fotografitë e përfshira konfirmojnë mbështetshmërinë në to.<sup>131</sup>

51. Dokumenti kryesisht përmban vështrime të oficerëve të përfshirë në bastisje.<sup>132</sup> Meqenëse raporti përmban dëshmi të dorës së dytë, Trupi Gjykues mund ta trajtojë këtë fakt duke u dhënë peshën përkatëse këtyre materialeve dhe duke mos marrë parasysh pretendimet që nuk mbështeten mjaftueshëm në prova

---

<sup>127</sup> SITF00189121-00189140 RED2; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

<sup>128</sup> *Shih në përgjithësi* SITF00189121-00189140 RED2; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

<sup>129</sup> *Shih* Aktakuzën e Ndryshuar, para. 87-90, 125-128, 168.

<sup>130</sup> SITF00189121-00189140 RED2, f. SITF00189121, SITF00189138; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

<sup>131</sup> SITF00189121-00189140 RED2, f. SITF00189124-SITF00189131, SITF00189133, SITF00189140; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

<sup>132</sup> *Shih në përgjithësi* SITF00189121-00189140 RED2; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 462.

ose nuk janë konfirmuar. Vlera provuese *prima facie* e këtij materiali nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se SITF00189121-00189140 RED2 është i pranueshëm si provë jogojore.

(c) Dokumente në lidhje me zhvarrimet

52. Një numër dokumentesh të paraqitura trajtojnë zhvarrimin e kufomave të viktimave. Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur,<sup>133</sup> të dy versionet e Konstatimeve të UNMIK-ut të Ekzaminimit të Nëntë Kufomave,<sup>134</sup> dhe shtesa e tyre<sup>135</sup> kanë të bëjnë me zhvarrimin dhe analizën e nëntë kufomave të zhvarrosura në Berishë, Kosovë.<sup>136</sup> ZPS-ja parashtron se këto materiale janë relevante për krimet që pretendohet se kanë ndodhur në Llapushnik.<sup>137</sup> Dokumentet tregojnë se kufomat në fjalë u përkasin personave që janë viktimat të identifikuara me emër në Aktakuzën e Ndryshuar, që pretendohet se u vranë në malet e Berishës afër Llapushnikut,<sup>138</sup> duke e bërë të qartë relevancën e tyre.

53. Edhe pse lidhja me lëndën e shumicës së këtyre dokumenteve është lehtësisht e dukshme, relevanca e një dokumenti kërkon shpjegim të mëtejshëm. ZPS-ja vë në dukje se raporti i UNMIK-ut për zhvarrimet<sup>139</sup> ka të bëjë me vrasjen e

---

<sup>133</sup> IT-03-66 P112; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 37. Keni parasysh se përkthimi në shqipe i këtij materiali është përfshirë në tri materiale të tjera me numra të ndryshëm të ERN-së. U008-6123-U008-6129-AT, U008-6077-U008-6084-AT, U008-1653-U008-1665-AT; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 38-40.

<sup>134</sup> U007-9551-U007-9600, IT-03-66 P111; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 42, 477.

<sup>135</sup> U008-6010-U008-6033; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 487.

<sup>136</sup> IT-03-66 P112, U007-9551-U007-9600, IT-03-66 P111, U008-6010-U008-6033; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 37, 42, 477, 487.

<sup>137</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, pjesa e tabelës "Relevanca/Vlera provuese" për materialet 37, 42, 477, 487.

<sup>138</sup> *Krahaso* IT-03-66 P112, U007-9551-U007-9600, IT-03-66 P111, U008-6010-U008-6033; *me* Aktakuzën e Ndryshuar, para. 146, Tabela B, rreshti 1, f. 60; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 37, 42, 477, 487.

<sup>139</sup> SPOE00073399-00073428; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 376.

pretenduar të një viktime të identifikuar me emër në Aktakuzën e Ndryshuar.<sup>140</sup> Raporti trajton një zhvarrosje që ndodhi në shpellën e Volljakut.<sup>141</sup> Megjithëse emrat e viktimave nuk janë në dokument,<sup>142</sup> relevanca e tij bëhet e qartë kur vlerësohet së bashku me raportin mjekoligjor të UNMIK-ut.<sup>143</sup> Në raportin mjekoligjor të UNMIK-ut thuhet se, edhe pse kufomat ishin gjetur në varrezat e Pejës, ato ishin zhvendosur në varrezat e Pejës nga shpella e Volljakut, ku pretendohet se ndodhi vrasja e paligjshme.<sup>144</sup> Për këtë arsye, raporti i zhvarrimit i UNMIK-ut është relevant për vrasjen e pretenduar të viktimës së identifikuar me emër në Aktakuzën e Ndryshuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se secili prej materialeve është relevant sepse ka të bëjë me zhdukjen dhe vrasjen e pretenduar të viktimave të identifikuara me emër në këtë çështje.

54. Secili material përmban shenja të dokumenteve autentike, përfshirë emblemën në faqen e parë, stemat, emrat e përpiluesit të dokumentit, dhe fushat për nënshkrim.<sup>145</sup> Trupi Gjykses është bindur se këto dokumente janë autentike *prima facie*.

55. Informacioni i dhënë në këto dokumente trajton rrethanat e zhdukjes dhe vrasjes së paligjshme të viktimave të identifikuara në Aktakuzën e Ndryshuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ato kanë vlerë provuese *prima facie* në lidhje me këto aspekte.

---

<sup>140</sup> S *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, shtylla e tabelës “Relevanca/Vlera provuese” për materialin 376.

<sup>141</sup> *Shih në përgjithësi* SPOE00073399-00073428; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 376.

<sup>142</sup> *Shih në përgjithësi* SPOE00073399-00073428; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 376.

<sup>143</sup> SPOE00068624-00068634; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 382.

<sup>144</sup> SPOE00068624-00068634, f. SPOE00068631; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 382.

<sup>145</sup> *Shih në përgjithësi* IT-03-66 P112, U007-9551-U007-9600, SPOE00073399-00073428, SPOE00068624-00068634, IT-03-66 P111, U008-6010-U008-6033; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 37, 42, 376, 382, 477, 487.

56. Trupi Gjykses vë në dukje se, megjithëse të gjitha këto materiale përmbajnë dëshmi të dorës së dytë, Trupi Gjykses mund t'i shqyrtojë këto aspekte duke u dhënë peshën përkatëse këtyre materialeve dhe duke shpërfillur ato pretendime apo pohime që nuk mbështeten mjaftueshëm në prova ose nuk konfirmohen nga to. Vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

57. Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se IT-03-66 P112, U007-9551-U007-9600, SPOE00073399-00073428, SPOE00068624-00068634, IT-03-66 P111 dhe U008-6010-U008-6033 janë të pranueshme si prova jogojore.

(d) Dokumentet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë

58. Dokumenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë është dëftesë për kthimin e gjërave personale të një polici pas vdekjes dhe rrëmbimit të pretenduar nga një "bandë terroriste".<sup>146</sup> ZPS-ja pohon se ky dokument është relevant për krimet në aktakuzë që kanë ndodhur në Llapushnik.<sup>147</sup> Megjithëse Trupi Gjykses pranon se dokumenti nuk përmend rajonin as datën e rrëmbimit ose të vrasjes së pretenduar<sup>148</sup> dhe viktimat e pretenduar nuk përmendet në Aktakuzën e Ndryshuar ku diskutohet Llapushniku, e as në tabelat shoqëruese,<sup>149</sup> dokumenti megjithatë është relevant. Dokumenti është relevant, ndër të tjera, për të vërtetuar një krim të pretenduar që, nëse atribuohet, mund të jetë relevant për të përcaktuar ekzistencën e sulmit të gjerë dhe/ose sistematik ndaj popullatës civile dhe/ose praktikën e sjelljes që është relevante për konstatimet që duhet të nxjerrë Trupi Gjykses.

---

<sup>146</sup> IT-03-66 P209; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 514.

<sup>147</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore shtylla e tabelës, "Paragrafët kryesorë të Aktakuzës" për materialin 514.

<sup>148</sup> IT-03-66 P209; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 514.

<sup>149</sup> *Shih në përgjithësi* Aktakuza e Ndryshuar, para. 64, 101, 145-146, Tabela B, f. 62.

59. Sa i përket autenticitetit, dokumenti përmban të gjitha shenjat shoqëruese, vulat dhe nënshkrimet në përputhje me një dokument zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dokumenti është autentik *prima facie*.

60. Sa i përket vlerës provuese *prima facie*, ky dokument ka vlerë provuese për elementin kontekstual të sulmit të pretenduar gjerësisht të përhapur dhe sistematik ndaj popullatës civile në përgjithësi, dhe të vënies në shënjestër të personave të lidhur me autoritetet serbe në veçanti.

61. Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese *prima facie* e këtij dokumenti nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij. Trupi Gjykses vë në dukje, konkretisht, se nuk i atribuon asnjë prej veprimeve të pretenduara anëtarëve të pretenduar të UÇK-së ose të akuzuarve, sepse për këtë mund të pyeten dëshmitarët gjatë marrjes në pyetje nga pala jothirrëse, dhe se fakti që informacioni që përmban ai nuk është verifikuar përmes dëshmitarit do të merret parasysh gjatë marrjes së vendimit se çfarë peshe duhet t'i jepet.

62. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se IT-03-66 P209 është i pranueshëm si provë jogojore.

(e) Kablllogrami i ambasadës së SHBA-së në Beograd, Serbi

63. Përmbajtja e kablllogramit nga ambasada e SHBA-së në Beograd, Serbi, kryesisht ofron përshkrime të rrethanave në terren në nëntor 1998, përfshirë vendet ku anëtarë të UÇK-së pretendohet se ndaluan dhe torturuan dy policë, dhe të një postblloku të UÇK-së.<sup>150</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ky dokument është relevant, në veçanti, sa i përket ekzistencës së pretenduar të

---

<sup>150</sup> 102870-102875; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 525.

praktikave të krimeve që i atribuohen anëtarëve të asaj organizate dhe ekzistencës së pretenduar të sulmit gjerësisht të përhapur dhe/ose sistematik ndaj popullatës civile.

64. Kabllogrami duket të jetë autentik. Ai përmban etiketa që i referohen Departamentit të Shtetit të SHBA-së, numrin e çështjes që i është caktuar, dhe klasifikimin.<sup>151</sup> Ai gjithashtu përmban datën kur ky dokument u deklasifikua.<sup>152</sup> Trupi Gjykses është bindur se ai është autentik *prima facie*.

65. Kabllogrami duket se jep informacion në lidhje me krimet e pretenduara që i atribuohen anëtarëve të UÇK-së, si dhe në lidhje me një postbllok të UÇK-së gjatë periudhës së aktakuzës. Trupi Gjykses konstaton se ky informacion ka vlerë provuese *prima facie*.

66. Fakti që disa nga provat aty janë dëshmi të dorës së dytë nuk është bazë, pa dëshmi të tjera, për ta refuzuar. Kjo do të merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së provave të tilla. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se Mbrojtja do të jetë në gjendje të marrë në pyetje në lidhje me këtë material së paku dy dëshmitarë të ZPS-së që cilat ende nuk janë paraqitur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e këtij materiali nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij.

67. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se 102870-102875 është i pranueshëm si provë jogojore.

---

<sup>151</sup> *Shih në përgjithësi 102870-102875; shih Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 525.*

<sup>152</sup> *Shih në përgjithësi 102870-102875; shih Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 525.*

## (f) Dokumentacioni i OSBE-së

68. U007-9607-U007-9661 është përzgjedhje e dokumentacionit të OSBE-së që kryesisht përmban raporte për persona të zhdukur dhe incidente.<sup>153</sup> Përmbajtja e këtyre dokumenteve ka të bëjë me rrëmbimin e pretenduar të civilëve nga UÇK-ja. SPOE00233999-00234000 është dokument që përmban procesverbalin e një mbledhje midis punonjësve të OSBE-së dhe anëtarëve të UÇK-së në lidhje burgosjen e pesë civilëve.<sup>154</sup> SPOE00233700-00233701<sup>155</sup> është raport i Patrullës së OSBE-së. Dokumenti evidenton një ngjarje ku anëtarët e UÇK-së në një postbllok nuk kishin autoritet të lejonin punonjësit e OSBE-së të kalonin pa autorizim prej eprorëve të tyre.<sup>156</sup> SPOE00109507-00109518<sup>157</sup> përmban shënime të shtypura nga fletorja e W04067-ës. Këto shënime duket se paraqesin takimet me përfaqësues të UÇK-së në lidhje me marrjen e pengjeve.<sup>158</sup> SPOE00061164-00061168<sup>159</sup> është raport javor i misionit të OSBE-së. Dokumenti përmban deklarata të pretenduara ku thuhet se z. Thaçi premtoi se UÇK-ja nuk do t'i sulmojë forcat jugosllave dhe se anëtarët e UÇK-së do të qëndrojnë në bastionet e tyre deri në arritjen e NATO-s.<sup>160</sup> SPOE00060952-00060954<sup>161</sup> është raport i përkohshëm i OSBE-së. Ndër të tjera, në raport diskutohet lirimi i katër të burgosurve nga UÇK-ja. Dy ishin gazetarë dhe dy ishin shqiptarë që u mbajtën të ndaluar për shpërndarjen e propagandës kundër UÇK-së.<sup>162</sup> SPOE00060865-00060865<sup>163</sup> është një vlerësim i atypëratyshëm i pretenduar i OSBE-së. Në të diskutohet marrëdhënia dhe dinamika e

---

<sup>153</sup> U007-9607-U007-9661; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 41.

<sup>154</sup> *Shih në përgjithësi* SPOE00233999-00234000; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 211.

<sup>155</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 212.

<sup>156</sup> SPOE00233700-00233701; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 212.

<sup>157</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 375.

<sup>158</sup> SPOE00109507-00109518; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 375.

<sup>159</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 384.

<sup>160</sup> SPOE00061164-00061168; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 384.

<sup>161</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 386.

<sup>162</sup> SPOE00060952-00060954; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 386.

<sup>163</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 387.

kompetencave midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.<sup>164</sup> SPOE00060777-00060785<sup>165</sup> paraqet bisedat midis përfaqësuesve të OSBE-së dhe komandantit të zonës së UÇK-së, ku thuhet se ai sugjeroi se ishte në gjendje që përfaqësuesve të OSBE-së në rajon t'u siguronte mbrojtje nga autoritetet serbe.<sup>166</sup> Komandanti i zonës gjithashtu thuhet se kishte pranuar se mbante të burgosur shqiptarë.<sup>167</sup> IT-03-66 P46<sup>168</sup> është raport i OSBE-së për persona të zhdukur në lidhje me një viktimë të identifikuar me emër.<sup>169</sup> Në të thuhet konkretisht se viktima ishte kapur dhe ishte marrë nga anëtarë të UÇK-së.<sup>170</sup> Duke u bazuar në lëndën e këtyre dokumenteve dhe përmbajtjen e tyre, që mbulojnë të gjitha rrëmbimet dhe ndalimet e civilëve nga UÇK-ja, si dhe kompetencën e pretenduar të z. Thaçi për këto veprime, Trupi Gjykses konstaton se këto dokumente janë relevante.

69. SPOE00059723-00059725<sup>171</sup> është dokument në lidhje me një mbledhje në të cilën përfaqësues të ndryshëm shtetërorë diskutuan realizueshmërinë e absorbimit të punonjësve dhe mjeteve të Misionit të Vëzhguesve Diplomatikë në Kosovë në Misionin Verifikues në Kosovë.<sup>172</sup> ZPS-ja pretendon se SPOE00059723-00059725 është relevant sepse jep një historik të konfliktit.<sup>173</sup> UÇK-ja nuk përmendet në këtë dokument. ZPS-ja nuk ka vërtetuar relevancën e këtij dokumenti për procesin gjyqësor. Rrjedhimisht, SPOE00059723-00059725 nuk do të pranohet. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se ky dokument përfshin informacion që do të paraqitet nga dëshmitari i ardhshëm i ZPS-së, W04147,

---

<sup>164</sup> SPOE00060865-00060865; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 387.

<sup>165</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 388.

<sup>166</sup> SPOE00060777-00060785; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 388.

<sup>167</sup> SPOE00060777-00060785; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 388.

<sup>168</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 507.

<sup>169</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 146.

<sup>170</sup> IT-03-66 P46; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 507.

<sup>171</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 389.

<sup>172</sup> SPOE00059723-00059725; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 389.

<sup>173</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 389.

kështu që ZPS-ja mund të përpiket të vërtetojë relevancën e tij përmes këtij dëshmitari.

70. Formatimi dhe struktura e dokumenteve përkatëse përputhen me raportet zyrtare të OSBE-së,<sup>174</sup> dhe Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të tyre, me dy përjashtime të trajtuara më poshtë.<sup>175</sup>

71. Sa u përket SPOE00109507-00109518<sup>176</sup> dhe SPOE00060865-00060865,<sup>177</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se ato nuk kanë kreun e faqes as stemën. Megjithëse ZPS-ja parashtron se W04067 mund të konfirmojë autenticitetin e SPOE00109507-00109518 dhe W04401 mund të konfirmojë autenticitetin e SPOE00060865-00060865, Trupi Gjykses ende nuk ka dëgjuar dëshmitë as të W04067-ës as të W04401-shit. Por autenticiteti dhe vlera provuese e këtyre materialeve do të varen në masë të madhe nga aftësia e ZPS-së për të vërtetuar bazën, burimin dhe autorësinë e këtyre dokumenteve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e këtyre dokumenteve.

72. Sa i përket vlerës provuese, Trupi Gjykses vë në dukje se dokumentet e mbetura konkretisht trajtojnë: (i) pushtetin e pretenduar të UÇK-së për të ndaluar civilë dhe për të marrë pengje;<sup>178</sup> (ii) rrëmbimet konkrete që pretendohet se kreu UÇK-ja;<sup>179</sup> (iii) llojin e strukturës komanduese të UÇK-së gjatë periudhës së aktakuzës;<sup>180</sup> dhe (iv) pushtetin e pretenduar të z. Thaçi mbi veprimet e UÇK-së.<sup>181</sup>

---

<sup>174</sup> *Shih p.sh.* Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 47, 50 (ku konstatohet se gjashtë materiale të OSBE-së me tregues të ngjashëm janë autentikë *prima facie* dhe të pranueshëm).

<sup>175</sup> SPOE00109507-00109518, SPOE00060865-00060865; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 375, 387.

<sup>176</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 375.

<sup>177</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 387

<sup>178</sup> SPOE00060952-00060954; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 386.

<sup>179</sup> U007-9607-U007-9661, SPOE00233999-00234000, SPOE00060777-00060785, IT-03-66 P46; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 41, 211, 388, 507.

<sup>180</sup> SPOE00233700-00233701; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 212.

<sup>181</sup> SPOE00061164-00061168; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 384.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se këto materiale kanë vlerë provuese *prima facie*.

73. Në lidhje me atë nëse vlera provuese *prima facie* e materialeve të mbetura zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre, Trupi Gjykses vë në dukje se, ndërsa i gjithë dokumentacioni i OSBE-së përmban informacion të dorës së dytë, Trupi Gjykses mund t'i trajtojë këto aspekte duke u dhënë peshën përkatëse këtyre materialeve dhe të shpërfillë ato pretendime apo argumente që nuk janë të bazuara në mënyrë të mjaftueshme gjatë kuvendimeve përfundimtare. Elementet e dokumenteve që i kundërshton Mbrojtja mund të testohen në mënyrë efektive përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese *prima facie* e këtyre materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

74. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon IT-03-66 P46, SPOE0006077-00060785, SPOE00061164-00061168, SPOE00060777-00060785, SPOE00060952-00060954, SPOE00233700-00233701, SPOE00233999-00234000, dhe U007-9607-U007-9661 f. U007-9607 deri U007-9617 dhe U007-9621 deri U007-9661<sup>182</sup> si prova jogojore dhe refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e SPOE00059723-00059725, SPOE00060865-00060865 dhe SPOE00109507-00109518.

(g) Dokumentacioni i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ("PSRK")

75. ZPS-ja paraqet një dokument që PSRK-ja ia dha Task Forcës Hetimore Speciale në vitin 2015.<sup>183</sup> 034163-034165 e ka titullin "Vizitë e përfaqësuesve të partive politike të Kosovës te popullata civile e zhvendosur".<sup>184</sup> Pas këtij titulli

---

<sup>182</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 41 (ku vihet në dukje se ZPS-ja nuk kërkon pranimin e f. U007-9618-U007-9620, të cilat përmbajnë një deklaratë të W04395-ës dhe për të cilat u konstatua se janë të përshtatshme për pranim në Vendimin e Katërt sipas Rregullës 154, *shih më lart* poshtëshënimin 14).

<sup>183</sup> 034163-034165; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 634.

<sup>184</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 634.

vijon një listë e emrave dhe të posteve dhe lidhjeve politike përkatëse.<sup>185</sup> ZPS-ja pretendon se ky dokument është relevant për arrestimin dhe ndalimin nga UÇK-ja të personave në Qirez në shtator 1998.<sup>186</sup> Provat për këtë ngjarje tashmë janë në dokumentacionin e çështjes përmes dëshmisë së W03825-ës<sup>187</sup> dhe përmes provave materiale të pranuar më parë.<sup>188</sup> Rrjedhimisht, 034163-034165 është relevant për vepra penale konkrete të pretenduara dhe pretendimin e ZPS-së për politikën e UÇK-së të vënies në shënjestër të kundërshtarëve (politikë). Ai është relevant gjithashtu sepse konfirmon provat që tashmë janë në dokumentacionin e çështjes.

76. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses vë në dukje se, megjithëse në vetë dokumentin nuk është dhënë asnjë autor apo burim, ai përmban datë dhe ka kreun e faqes dhe strukturën që tregon se është dokumentacion zyrtar. Lloji i shkrimit, formati dhe në dukje qëllimi i synuar për nxjerrjen e identitetit të atyre përfaqësuesve politikë që merrnin pjesë në udhëtimin nëpër vende në Kosovë përputhet me dokumentin që buron nga UNMIK-u që tashmë është pranuar si provë.<sup>189</sup> Gjithashtu, dokumenti në fjalë mban datën 29 gusht 1998, dhe identifikon Bellanicën, Ngucatin, dhe Senikun si vende për të vizituar gjatë këtij udhëtimi. Kjo është në përputhje me informacionin që tashmë është pranuar si provë.<sup>190</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dokumenti është autentik *prima facie*.

77. Dokumenti ka vlerë provuese *prima facie*, sepse identifikon postet politike të atyre që u rrëmbyen më vonë, dhe rrjedhimisht mund të jenë relevant për përcaktimin e arsyeve të arrestimit dhe keqtrajtimit të pretenduar të tyre. Siç është

---

<sup>185</sup> 034163-034165; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 634.

<sup>186</sup> *Shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 634.

<sup>187</sup> Transkripti i seancës, Trupi Gjykses, 6 nëntor 2023, f. 9332, rreshti 17 deri f. 9333, rreshti 8; f. 9338, rreshti 15 deri f. 9340, rreshti 22.

<sup>188</sup> *Shih* 034157-034158 (u pranua si P00319 më 28 gusht 2023); 034172-034173 (u pranua si P00320 më 28 gusht 2023); DHT01418-DHT01422 (u pranua si 1D00038 më 28 gusht 2023).

<sup>189</sup> *Krahaso* SITF00055872-SITF00055873, f. SITF00055873 (u pranua si P00682 më 6 nëntor 2023).

<sup>190</sup> *Shih* 034138-034141-ET, f. 034138 (u pranua si P00681-ET më 7 nëntor 2023).

vënë në dukje më herët, ai gjithashtu konfirmon provat në lidhje me rrëmbimin e pretenduar që tashmë janë në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.

78. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e këtij dokumenti nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij. Së pari, në të UÇK-ja nuk përmendet konkretisht, e as ndonjë sjellje kriminale e pretenduar. Së dyti, në lidhje me të janë paraqitur prova nga dëshmitarë të ZPS-së dhe Mbrojtja mundi të kundërshtonte.

79. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se 034163-034165 është i pranueshëm si provë jogojore.

(h) Përfundim

80. Bazuar në sa më lart në lidhje me dokumente zyrtare të organizatave, Trupi Gjykses pranon IT-03-66 P46, IT-03-66 P111, IT-03-66 P112, IT-03-66 P209, SITF00143980-00143983, SITF00189121-00189140 RED2, SPOE00073399-00073428, SPOE00068624-00068634, SPOE0006077-00060785, SPOE00060952-00060954, SPOE00233700-00233701, SPOE00233999-00234000, SPOE00061164-00061168, SPOE00060777-00060785, U007-9551-U007-9600, U007-9607-U007-9661 f. U007-9607 deri U007-9617 dhe U007-9621 deri U007-9661, U008-6010-U008-6033, U008-9781-U008-9974, 034163-034165, 102870-102875 si prova jogojore dhe refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e SPOE00059723-00059725, SPOE00060865-00060865 dhe SPOE00109507-00109518 si prova jogojore.

## 5. Kategoria 5: Dokumentet e lidhura me UÇK-në

### (a) Urdhrat dhe kërkesat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së

81. ZPS-ja kërkon pranimin e 15 dokumenteve që përmbajnë urdhra dhe kërkesa të lëshuara nga anëtarë të UÇK-së.<sup>191</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>192</sup>

82. Mbrojtja përgjigjet se dokumentet që kanë të bëjnë me dëshmitarë të ZPS-së duhet të paraqiten përmes dëshmitarëve përkatës në përputhje me parimin e paraqitjes së dëshmimeve gojore.<sup>193</sup> Mbrojtja pohon se Dhomat Gjyqësore para TPNJ-së kanë konstatuar në mënyrë të përsëritur se paraqitja e dokumenteve përmes dëshmitarëve është mënyra e parapëlqyer, kurse mocioni i provave jогоjore është mënyrë shtesë që duhet të përdoret në mënyrë të kursyer.<sup>194</sup> Së fundi, Mbrojtja parashtron se, edhe pse ZPS-ja është paralajmëruar për rëndësinë e shpjegimit se pse materialet nuk mund të paraqiten përmes dëshmitarit, ajo nuk ofron këtë shpjegim, po vetëm rendit materialet e rëndësishme që duket se kanë lidhje të drejtpërdrejtë me dëshmitarë dhe rrjedhimisht këto materiale duhet të refuzohen.<sup>195</sup>

83. Trupi Gjykues konstaton se dokumentet përfshijnë: (i) një dokument të Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së dërguar komandës së Zonës Operative të Nerodimes, të nënshkruar nga shefi i Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-

---

<sup>191</sup> U017-3162-U017-3162, U001-1387-U001-1387, U001-1383-U001-1383, U000-7803-U000-7803, U000-7734-U000-7734, U000-5385-U000-5385, U000-4400-U000-4400, U000-0529-U000-0529, SITF40001762-40001763, SITF00242605-00242605, SITF00242603-00242603, SITF00242583-00242583, IT-05-87\_1 P00441, SITF00069017-SITF00069017, IT-05-87 P02461; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jогоjore, materialet 5, 92, 94, 144, 150, 168, 172, 189, 418, 446, 448, 450, 489, 471, 495.

<sup>192</sup> Mocioni i Provave Jогоjore, para. 3.

<sup>193</sup> Përgjigjja, para. 52; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 15-16, 19-20, 85-85, 89-90, 92-93; Shtojcën 6.2.1 të Përgjigjes, f. 19-20, 22-23; Shtojcën 6.2.4 të Përgjigjes, f. 7-11, 17-18; Shtojcën 6.2.5 të Përgjigjes, f. 2, 6-10.

<sup>194</sup> Përgjigjja, para. 53.

<sup>195</sup> Përgjigjja, para. 54.

së;<sup>196</sup> (ii) dy urdhra të Zonës Operative të Nerodimes dërguar nga, përkatësisht, komandanti i Batalionit të Parë dhe nga Komandant Graniti;<sup>197</sup> (iii) dy kërkesa për personel shtesë dhe për kthimin e gjërave personale shtabit operativ lokal, nënshkruar nga W04290;<sup>198</sup> (iv) tre urdhra të nënshkruar nga W04752;<sup>199</sup> (v) një vendim për masa disiplinore ndaj ushtarëve të Brigadës 125 të UÇK-së, dërguar Zonës Operative të Nerodimes, nënshkruar nga Komandant Graniti;<sup>200</sup> (vi) një vendim që ndalon komunikimin me gazetarë, nënshkruar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së;<sup>201</sup> (vii) një kërkesë për një pjesë të personelit komandues të UÇK-së që të bartin armë brezi, nënshkruar nga z. Thaçi;<sup>202</sup> dhe (viii) katër vendime për arrestimin e katër individëve, përfundimin e ndalimit të tyre, apo dhënien e amnistisë.<sup>203</sup>

84. Trupi Gjykes konstaton se këto dokumente janë, ndër të tjera, të rëndësishme për: (i) organizimin dhe funksionimin e UÇK-së dhe të zinxhirit komandues të saj dhe aspektin e lidhur me llojin e konfliktit të armatosur të pretenduar; (ii) organizimin, strukturën, autoritetin dhe veprimet e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së; (iii) rolin e W04752-shit brenda UÇK-së; (iv) ndalimin e individëve në Llapashticë; (v) funksionimin e zonave operative; dhe (vi) zbatimin e rregullave dhe rregulloreve nga UÇK-ja dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.<sup>204</sup>

---

<sup>196</sup> U017-3162-U017-3162; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 5.

<sup>197</sup> U001-1387-U001-1387, U001-1383-U001-1383; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 92, 94.

<sup>198</sup> U000-7803-U000-7803, U000-7734-U000-7734; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 144, 150.

<sup>199</sup> U000-5385-U000-5385, IT-05-87\_1 P00441, IT-05-87 P02461; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 168, 489, 495.

<sup>200</sup> U000-4400-U000-4400; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 172.

<sup>201</sup> U000-0529-U000-0529; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 189.

<sup>202</sup> SITF40001762-40001763; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 418.

<sup>203</sup> SITF00242605-00242605, SITF00242603-00242603, SITF00242583-00242583, SITF00069017-SITF00069017; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 446, 448, 450, 471.

<sup>204</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 15, 19, 37, 71-73, 107-108.

85. Duke iu kthyer autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur se të gjitha materialet janë autentike *prima facie*. Konkretisht, Trupi Gjykses vë në dukje se të gjitha materialet: (i) përmbajnë data; (ii) përveç dy prej tyre, përmbajnë numra të dokumentit; (iii) përveç njërit, ose janë të nënshkruara, ose përmbajnë hapësirën për nënshkrim që nuk është nënshkruar nga anëtari i UÇK-së; dhe (iv) kanë kreun e faqes me simbole të UÇK-së. Shtatë materiale kanë stemën e UÇK-së, vulën e UÇK-së, ose të dyja. Gjithashtu, në shumë prej këtyre materialeve thuhet se u lëshuan në pajtim me Rregulloren e Brendshme të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së (P00648), që e shton edhe më shumë autenticitetin *prima facie* të tyre.<sup>205</sup>

86. Trupi Gjykses është bindur për vlerën provuese *prima facie* të të gjitha materialeve. Ato kanë të bëjnë me aspekte të përshkruara më lart, në veçanti, sa u përket roleve dhe përgjegjësisë të zyrtarëve të ndryshëm të UÇK-së. Të gjitha, në shikim të parë të dokumenteve, duket se janë urdhra dhe kërkesa të nënshkruara prej tyre, që ka rëndësi për akuzat. Forma e këtyre dokumenteve është në përputhshmëri me urdhra të tjerë të ofruar në këtë pjesë, ose të pranuar si prova, që edhe më shumë e shton vlerën provuese *prima facie*.<sup>206</sup>

87. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 86 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës. Fakti që një material është nënshkruar nga z. Thaçi nuk e ndryshon këtë konstatim.

88. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se, në qoftë se një dokument përmban nënshkrimin e dëshmitarit të thirrur nga pala thirrëse për të dhënë dëshmi, dhe ka mospajtime për përmbajtjen ose autorësinë e dokumentit, në parim, ai duhet t'i tregohet dëshmitarit që të komentojë lidhur me të. Nëse pala thirrëse nuk e bën

---

<sup>205</sup> *Shih, për shembull*, SITF00242605-00242605, SITF00242603-00242603, SITF00069017-SITF00069017, dhe IT-05-87 P02461; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 446, 448, 471, 495.

<sup>206</sup> *Shih, për shembull*, Vendimin e Pestë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 62-69.

këtë, kjo mund të ndikojë në peshën që Trupi Gjykses mund të jetë i gatshëm t'i japë atij dokumenti.

89. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U017-3162-U017-3162, U001-1387-U001-1387, U001-1383-U001-1383, U000-7803-U000-7803, U000-7734-U000-7734, U000-5385-U000-5385, U000-4400-U000-4400, U000-0529-U000-0529, SITF40001762-40001763, SITF00242605-00242605, SITF00242603-00242603, SITF00242583-00242583, IT-05-87\_1 P00441, SITF00069017-SITF00069017, dhe IT-05-87 P02461.

(b) Rregulloret, programi dhe dokumentet e stërvitjes të UÇK-së

90. ZPS-ja kërkon pranimin e shtatë dokumenteve që përmbajnë rregullore, programe dhe dokumente të stërvitjes së UÇK-së.<sup>207</sup> ZPS-ja parashton se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se pranimi i tyre si prova nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>208</sup>

91. Mbrojtja përgjigjet se udhëzuesit, rregullat dhe rregulloret nuk duhet të pranohen si prova jोगojore pa informacion se kur, ku dhe si ishin shpërndarë dhe për kë vlenin ato.<sup>209</sup> Mbrojtja parashton se këto materiale nuk përmbajnë pothuajse asnjë tregues të autenticitetit, pasi që shpesh nuk përmbajnë pothuajse asnjë informacion në lidhje me autorësinë, përtej stemës së UÇK-së, datës së dokumentit dhe mënyrës në të cilën ishin siguruar përveç frazave të përgjithshme, si ajo që ishte siguruar nga TPNJ-ja, ose ishte sekuestruar prej të akuzuarve, dhe se ZPS-ja nuk ka treguar në mënyrë të mjaftueshme rëndësinë e çdo materiali.<sup>210</sup>

---

<sup>207</sup> U017-3364-U017-3364, U001-7342-U001-7342, U001-7059-U001-7061, U001-4904-U001-4913, U000-6413-U000-6413, U000-0410-U000-0444, SITF00009608-SITF00009610; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jोगojore, materialet 1, 70, 72, 80, 162, 193, 476.

<sup>208</sup> Mocioni i Provave Jोगojore, para. 3.

<sup>209</sup> Përgjigjja, para. 102.

<sup>210</sup> Përgjigjja, para. 103; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 13-14; Shtojca 6.2.5 e Përgjigjes, f. 1-2; Shtojca 6.5 e Përgjigjes, f. 2-6, 10-11, 16.

Së fundi, Mbrojtja argumenton se, duke pasur parasysh se ZPS-ja synon të paraqesë këto materiale për të provuar elemente që janë kyçe për argumentet e saj, konkretisht, nivelin e organizimit të UÇK-së dhe pushtetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pranimi i tyre si prova jोगojore do të cenonte të akuzuarit, të cilët nuk do të kenë mundësinë të kundërshtojnë pranueshmërinë e këtij materiali përmes dëshmitarëve. Mbrojtja argumenton se ky cenim rritet për faktin që ZPS-ja synon të thërrasë dëshmitarë që mbanin pozita udhëheqëse në UÇK.<sup>211</sup>

92. Sa përket parashtrimeve të Mbrojtjes se këto dokumente janë tepër të rëndësishme për t'u pranuar si prova jोगojore, Trupi Gjykues kujton konstatimin e vet të mëparshëm në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jोगojore se, edhe rregullat dhe rregulloret mund të tregojnë se ishin miratuar dhe një shkallë të caktuar të organizimit të UÇK-së, ai do t'i bazojë konstatimet e veta në lidhje me këtë aspekt duke pasur parasysh të gjitha provat përkatëse. Në veçanti, do të shqyrtojë jo vetëm ekzistencën e këtyre rregullave dhe rregulloreve, por gjithashtu edhe shkallën e zbatimit dhe imponimit konkret të tyre.<sup>212</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues vë në dukje se të njëjtat kushte dhe kritere për pranim, siç janë përcaktuar në rregullën 138(1), zbatohen për të gjitha kategoritë e provave materiale të propozuara, pavarësisht nga rëndësia (e perceptuar) e tyre për argumentet e një pale.

93. Trupi Gjykues gjykon më tej se këto dokumente përfshijnë: (i) një sqarim të Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së të detyrave të komandantëve të zonave operative sipas Rregullores së Policisë Ushtarake;<sup>213</sup> (ii) një dokument me titull "Policia Ushtarake dhe Detyrat e saj – Rregullore të Përgjithshme";<sup>214</sup> "Rregullorja

---

<sup>211</sup> Përgjigjja, para. 105.

<sup>212</sup> Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jोगojore, para. 80.

<sup>213</sup> U017-3364-U017-3364; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jोगojore, materiali 1.

<sup>214</sup> U001-7342-U001-7342; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jोगojore, materiali 70.

e Shërbimit të Zbulimit Ushtarak në Nivel Rrethi” e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;<sup>215</sup> (iv) “Rregullorja për funksionimin e UÇK-së në Zonën e Dukagjinit” e UÇK-së;<sup>216</sup> (v) sqarim i nënshkruar nga W04752 midis kompanisë 2 dhe 3 të UÇK-së dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;<sup>217</sup> (vi) “Rregullorja Disiplinore për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës”;<sup>218</sup> dhe (vii) “Udhëzues për Zbatimin e Procedurave ndaj të Paraburgosurve” i Shërbimit Gjyqësor të UÇK-së.<sup>219</sup>

94. Trupi Gjyqësor konstaton se këto dokumente janë relevante, ndër të tjera: (i) për kompetencën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Policisë Ushtarake të UÇK-së për të miratuar rregullore, dhe aspekte të tjera të pushtetit dhe përgjegjësi të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe anëtarëve të saj; (ii) për nivelin e koordinimit dhe organizimit të UÇK-së dhe të funksionimit të zinxhirit komandues; (iii) për hierarkinë në UÇK dhe në Policinë Ushtarake të UÇK-së dhe kompetencat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, sidomos në lidhje me aspekte disiplinore; (iv) për ekzistencën dhe elementet e konfliktit të armatosur në kohën përkatëse; dhe (v) për trajtimin e të ndaluarve.<sup>220</sup>

95. Duke iu kthyer autenticitetit, Trupi Gjyqësor gjykon se U017-3364-U017-3364, U001-7342-U001-7342, U001-7059-U001-7061, U001-4904-U001-4913, U000-6413-U000-6413, U000-0410-U000-0444, dhe SITF00009608-SITF00009610 janë autentikë *prima facie*.<sup>221</sup> Të gjitha këto dokumente, në shikim të parë, përmbajnë tregues që sugjerojnë se burojnë nga UÇK-së. Pesë prej tyre mbajnë datë, të gjitha kanë të daktilografuar kreun e faqes të UÇK-së, dy kanë numra të dokumentit, dy materiale kanë vulën e UÇK-së dhe janë të nënshkruara përkatësisht nga W04752 dhe W04264. Trupi Gjyqësor vë në dukje se dokumenti “Policia Ushtarake dhe

<sup>215</sup> U001-7059-U001-7061; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 72.

<sup>216</sup> U001-4904-U001-4913; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 80.

<sup>217</sup> U000-6413-U000-6413; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 162.

<sup>218</sup> U000-0410-U000-0444; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 193.

<sup>219</sup> SITF00009608-SITF00009610; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 476.

<sup>220</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 15, 18-19, 37, 39.

<sup>221</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 70, 72, 80, 162, 193, 476.

Detyrat e Saj – Rregullore e Përgjithshme” (U001-7342-U001-7342) nuk mban datë, por gjykon se autenticiteti i tij vërtetohet nga sqarimi në lidhje me këtë rregullore i lëshuar nga shefi i Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së më 17 dhjetor 1998 (U017-3364-U017-3364). Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se dokumenti “Rregullore e Shërbimit të Zbulimit në Nivel Rrethi” (U001-7059-U001-7061) nuk mban datë. Megjithatë, Trupi Gjykses gjykon se autenticiteti *prima facie* i këtij materiali mbështetet nga fakti që ka kreun e faqes të UÇK-së, dhe se formati, stili i shkronjave dhe struktura janë të ngjashme me dokumente të tjera që pretendohet se janë lëshuar nga UÇK-ja.<sup>222</sup>

96. Trupi Gjykses është bindur se U017-3364-U017-3364, U001-7342-U001-7342, U001-4904-U001-4913, U001-7059-U001-7061, U000-6413-U000-6413, U000-0410-U000-0444, dhe SITF00009608-SITF00009610 kanë vlerë provuese *prima facie*.<sup>223</sup> Ekzistojnë tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë për arsyet e shtjelluara në paragrafin 95 dhe ato janë fakte dhe rrethana relevante për të cilat ka mospajtime, sidomos në lidhje me aspekte që kanë të bëjnë me fuqinë dhe kompetencat e UÇK-së për aspekte disiplinore.<sup>224</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se një kopje e pjeshme e rregullores në U000-0410-U000-0444 u konfiskua në banesën e z. Krasniqi.<sup>225</sup> Trupi Gjykses nuk ka nevojë të përcaktojë identitetin e personit që shkroi këto dokumente në emër të UÇK-së, për qëllime të pranimit. Dhe, do të përcaktohet në fund të kësaj çështje gjyqësore nëse është fare relevante për konstatimet e Trupit Gjykses, duke marrë parasysh provat përkatëse para tij.

97. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 96 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të jetë këtë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes

---

<sup>222</sup> Shih për shembull, U001-7342-U001-7342, U001-4904-U001-4913; shih Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 70, 80.

<sup>223</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 70, 72, 80, 162, 193, 476.

<sup>224</sup> Shih më lart, para. 94.

<sup>225</sup> Shih P00640; Shih gjithashtu Vendimin e Pestë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 70-78; Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 225.

marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës dhe/ose të paraqesë dëshmi përkatëse në lidhje aspektet shqetësuese në ato materiale.

98. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U017-3364-U017-3364, U001-7342-U001-7342, U001-4904-U001-4913, U001-7059-U001-7061, U000-6413-U000-6413, U000-0410-U000-0444, dhe SITF00009608-SITF00009610.

(c) Dokumentet e shkruara me shkrim dore

99. ZPS-ja kërkon pranimin e nëntë dokumenteve të shkruara me shkrim dore.<sup>226</sup> ZPS-ja parashton se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre si prova nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>227</sup>

100. Mbrojtja përgjigjet se këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës,<sup>228</sup> se burimi i dokumenteve nuk dihet, se nuk janë autentike, se nuk lidhen në masë të mjaftueshme me veprat penale ose format e përgjegjësisë në Aktakuzën e Ndryshuar, dhe se vlera e tyre provuese zhbëhet në masë të konsiderueshme nga efekti dëmtues i tyre.<sup>229</sup>

101. Trupi Gjykses gjykon se këto dokumente përfshijnë materialet me shkrim dore në vijim: (i) shënime që përshkruajnë rutinën ditore në pikën e vëzhgimit 1 në Llapushnik dhe Glllogoc nga 1 deri 22 korrik 1998;<sup>230</sup> (ii) një ditar të Lahi Brahimajt me shënime për veprimtaritë ditore në Tiranë – Llapushnik midis datave 11 nëntor 1998 dhe 1 shkurt 1999;<sup>231</sup> (iii) vendime disiplinore kundër

<sup>226</sup> U002-3460-U002-3492, U002-0163-U002-0208, U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, U001-1381-U001-1381, U000-6954-U000-6978, SITF00244612-00244656; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 52, 62, 84, 86, 88, 90, 96, 160, 436; Njoftimi, para. 2.

<sup>227</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>228</sup> Përgjigjja, para. 52-55.

<sup>229</sup> Përgjigjja, para. 97-101; *Shih gjithashtu* Shtojcën 6.1 të Përgjigjes, f. 3-5, 10-11, 47-48; Shtojca 6.2.1 e Përgjigjes, f. 2-5, 39-40.

<sup>230</sup> U002-3460-U002-3492; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 52.

<sup>231</sup> U002-0163-U002-0208; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 62.

ushtarëve të ndryshëm dhe një urdhër, të gjitha të dërguara Ahmet Kaçikut dhe të nënshkruara nga Komandant Graniti i Zonës Operative të Nerodimes të UÇK-së;<sup>232</sup> (iv) një fletore me titull “Njësia Speciale e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së”;<sup>233</sup> dhe (v) shënime (45 faqe) që përfshijnë, ndër të tjera, lista të anëtarëve të UÇK-së, lista të pajisjeve dhe furnizimeve, dhe një urdhër të Kadri Kastratit.<sup>234</sup>

102. Trupi Gjykses konstaton se këto materiale kanë rëndësi, ndër të tjera, për aspektet në vijim: (i) funksionimin dhe organizimin e UÇK-së, në veçanti, veprimtarinë vëzhguese dhe zinxhirin komandues; (ii) ndërveprimin dhe koordinimin midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (iii) kompetencën e UÇK-së për zbatimin e masave disiplinore; (iv) ekzistencën dhe veprimtarinë e Njesisë Speciale të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe (v) politikën e pretenduar të UÇK-së ndaj kolaboracionistëve dhe zbatimin e saj.<sup>235</sup>

103. Duke iu kthyer autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur se U002-0163-U002-0208, U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, dhe U001-1381-U001-1381 janë autentike *prima facie*.<sup>236</sup> Të gjitha mbajnë data dhe nënshkrime. Gjithashtu, U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, dhe U001-1381-U001-1381 kanë numra të dokumentit, përputhen për nga forma me versionet e daktilografuara të urdhrave të ngjashëm të trajtuar më lart në paragrafët 81-87 dhe tri vendimet disiplinore u lëshuan në përputhje me Rregulloren Disiplinore të UÇK-së (P00162). Së fundi, Trupi Gjykses gjithashtu është bindur për autenticitetin *prima facie*: (i) të U002-3460-U002-3492, një fletore ku dokumentohen të gjitha vizitat në postbllokun ku janë regjistruar nga personeli vëzhgues të gjitha ardhjet, të cilat përmbajnë emrin dhe datën; (ii) të U002-0163-U002-0208, një ditar

<sup>232</sup> U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, U001-1381-U001-1381; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 84, 86, 88, 90, 96.

<sup>233</sup> U000-6954-U000-6978; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 160.

<sup>234</sup> SITF00244612-00244656; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 436.

<sup>235</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 15, 19, 36, 39.

<sup>236</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 62, 84, 86, 88, 90, 96.

që i atribuohet Lahi Brahimajt me shënime të detajuara të cilat "Lahiu" i ka nënshkruar dhe ua ka shënuar datën; (iii) të U000-6954-U000-6978, edhe pse i shkruar me dorë, është shënuar si dokument i UÇK-së (faqja e parë dhe faqja e fundit), disa shënime në të përmendin anëtarë të pretenduar të UÇK-së, dhe përmbajnë nënshkrimin dhe datën; gjithashtu, dokumenti përmban njoftime dhe kërkesa, që përputhen në formë me njoftime dhe kërkesa të ngjashme të daktilografuara;<sup>237</sup> dhe (iv) të SITF00244612-00244656, sepse përmban vulën e UÇK-së, në të renditen të dhëna të anëtarëve të pretenduar të UÇK-së, dhe shumë shënime në të përmbajnë edhe nënshkrimin edhe datën.

104. Trupi Gjykses është bindur se U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, dhe U001-1381-U001-1381 kanë vlerë provuese *prima facie*. Ekzistojnë tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë për arsyet e shtjelluara në paragrafin 103. Ata kanë të bëjnë, ndër të tjera, me rolin dhe përgjegjësitë e Komandant Granitit si komandant i Zonës Operative të Nerodimes. Ngjashëm, Trupi Gjykses është bindur për vlerën provuese *prima facie* të U002-3460-U002-3492, U002-0163-U002-0208, U000-6954-U000-6978, dhe SITF00244612-00244656. Ekzistojnë tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë për arsyet e shtjelluara në paragrafin 103. Materialet janë relevante, ndër të tjera, për kapacitetet logjistike të UÇK-së, funksionimin operativ të njësive përkatëse, mjetet e komunikimit brenda UÇK-së dhe kontrollin e UÇK-së mbi zonat nën mbikëqyrjen e saj.

105. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 104 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Këto materiale nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me veprimet që i atribuohen të akuzuarve. Gjithashtu, Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës.

---

<sup>237</sup> *Shih më lart*, para. 81-89; *Shih gjithashtu* Vendimin e Pestë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 62-69.

106. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U002-3460-U002-3492, U002-0163-U002-0208, U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, U001-1381-U001-1381, U000-6954-U000-6978, dhe SITF00244612-00244656.

(d) Deklaratat dhe raportet e komandantëve të zonave operative

107. ZPS-ja kërkon pranimin e pesë raporteve të komandantëve të zonave operative.<sup>238</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën, janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre si prova nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>239</sup>

108. Mbrojtja përgjigjet se: (i) këto dokumente duhet të paraqiten vetëm përmes autorëve të tyre përkatës; (ii) nuk dihet burimi origjinal i dokumenteve; (iii) ato nuk janë autentike; (iv) ato nuk lidhen në masë të mjaftueshme me veprat penale apo format e përgjegjesisë në Aktakuzën e Ndryshuar; dhe (v) vlera provuese e tyre zhbëhet në mënyrë të konsiderueshme nga efekti dëmtues i tyre. Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton disa materiale sepse, ndër të tjera, ato nuk mbajnë nënshkrim, nuk mbajnë vulë, nuk kanë tregues të autorësisë, burojnë nga organizata ndërkombëtare pa tregues të burimit (burimeve) fillestar (fillestare), dhe nuk lidhen në mënyrë të mjaftueshme me veprën (veprat) penale dhe formën (format) e përgjegjesisë të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar.<sup>240</sup>

109. Trupi Gjykses gjykon se dokumentet përfshijnë: (i) një raport të komandës së Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së në lidhje me arrestimin e Skender Hajdar Hoxhajt;<sup>241</sup> (ii) një grumbull të dokumenteve nga Zona Operative e

---

<sup>238</sup> U009-1995-U009-1995, U009-1663-U009-1676, U001-5808-U001-5808, U001-5245-U001-5245, U001-1094-U001-1094; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 21, 23, 74, 76, 98.

<sup>239</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>240</sup> Shtojca 6.1 e Përgjigjes, f. 90-91; Shtojca 6.2.3 e Përgjigjes, f. 2-8, 10-11; Shtojca 6.2.5 e Përgjigjes, f. 9

<sup>241</sup> U009-1995-U009-1995; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 21.

Dukagjinit, përfshirë një program për intensifikimin e propagandës, një listë të anëtarëve të Brigadës 132 të UÇK-së, raporte dërguar Maliq Ndrecajt, komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, nga shërbimi i zbulimit, dhe përgjigjet e tij dërguar shërbimit të zbulimit;<sup>242</sup> (iii) një raport të shkruar nga sektori i zbulimit pas marrjes në pyetje të Pashk Lulit;<sup>243</sup> (iv) një deklaratë të Isa R. Nikqit, inspektor i Brigadës 136, ku ai kërkon tërheqjen e vet nga hetimet/ekzaminimet e bashkëpunëtorëve të regjimit serb;<sup>244</sup> dhe (v) një raport ditor të komandantit të batalionit të Brigadës 161 të Zonës Operative të Nerodimes drejtuar komandantit të brigadës më 2 janar 1999;<sup>245</sup>

110. Trupi Gjykses konstaton se këto materiale janë relevante, ndër të tjera: (i) për politikën e pretenduar të UÇK-së ndaj “bashkëpunëtorëve” të dyshuar; (ii) për organizimin, kompetencat dhe strukturën komanduese të UÇK-së; dhe (iii) për funksionimin e zonave operative.<sup>246</sup>

111. Duke iu kthyer autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur se U009-1995-U009-1995, U009-1663-U009-1676, U001-5808-U001-5808, U001-5245-U001-5245, dhe U001-1094-U001-1094 janë autentike *prima facie*. Të gjitha kanë datën dhe kreun e faqes të UÇK-së. Një material gjithashtu përmban numrin e dokumentit;<sup>247</sup> një material është i nënshkruar;<sup>248</sup> një material mban fushën për nënshkrim me emrin “Isa Rexhep NIKQI”;<sup>249</sup> dy materiale janë të nënshkruara nga “Sektori i Zbulimit”;<sup>250</sup> dhe shtatë materiale që përfshihen në U009-1663-U009-1676 janë të nënshkruara ose nga “Sektori i Zbulimit”, ose nga z. Maliq Ndrecaj.<sup>251</sup> Të gjitha

---

<sup>242</sup> U009-1663-U009-1676; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 23.

<sup>243</sup> U001-5808-U001-5808; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 74.

<sup>244</sup> U001-5245-U001-5245; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 76.

<sup>245</sup> U001-1094-U001-1094; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 98.

<sup>246</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 15, 19, 36.

<sup>247</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 74.

<sup>248</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 98.

<sup>249</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 76.

<sup>250</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 21, 74.

<sup>251</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 23.

raportet identifikojnë se kujt i drejtohet raporti dhe kush e dërgoi raportin. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se jo secili prej dokumenteve në U009-1663-U009-1676 ka pranuesin dhe dërguesin, por shumica e atyre dokumenteve i kanë.<sup>252</sup>

112. Trupi Gjykses është bindur se U009-1995-U009-1995, U009-1663-U009-1676, U001-5808-U001-5808, U001-5245-U001-5245, dhe U001-1094-U001-1094 kanë vlerë provuese *prima facie*. Ekzistojnë tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë për arsyet e shtjelluara në paragrafin 111. Ata kanë të bëjnë me aspekte për të cilat ka mospajtime siç janë rolet dhe përgjegjësitë e komandantëve të zonave operative, ose të policisë ushtarake, dhe raportimin e tyre degëve të ndryshme, siç është sektori i zbulimit, dhe komunikimin me to. Gjithashtu, formatet e shumë prej këtyre raporteve përputhen në mes vete, që ua shton vlerën provuese *prima facie*.

113. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 112 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës.

114. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U009-1995-U009-1995, U009-1663-U009-1676, U001-5808-U001-5808, U001-5245-U001-5245, dhe U001-1094-U001-1094.

(e) Dokumentet e tjera të UÇK-së

115. ZPS-ja kërkon pranimin e dy materialeve të tjera për të cilat parashtron se burojnë prej UÇK-së.<sup>253</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me

---

<sup>252</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 23.

<sup>253</sup> U009-9397-U009-9403, SITF00333313-00333313; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 17, 430.

lëndën, janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>254</sup>

116. Mbrojtja përgjigjet se: (i) burimi origjinal i këtyre dokumenteve është i panjohur; (ii) ato nuk janë autentike sepse nuk janë nënshkruar dhe sepse burojnë nga organizata pa pasur tregues të burimit origjinal; (iii) nuk janë të lidhura në mënyrë të mjaftueshme me veprat penale apo format e përgjegjësisë në Aktakuzën e Ndryshuar; dhe (iv) vlera provuese e tyre zhbëhet në mënyrë të konsiderueshme prej efektit dëmtues të tyre.<sup>255</sup>

117. Trupi Gjykses gjykon se dokumentet përfshijnë: (i) një grumbull të dokumenteve, përfshirë Rregulloren e Shtabit Operativ të UÇK-së të Rrafshit të Dukagjinit për Policinë Ushtarake, një autorizim për Pjetër Shalën (“z. Shala”) që të marrë komandën e Brigadës 128 Sulmuese të Pashtrikut, të nënshkruar nga Azem Syla, caktimin e z. Shala në post të ri, një kërkesë të Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit dhe rregulloret e përkohshme ushtarake;<sup>256</sup> dhe (ii) një njoftim/apel ushtarak për t’iu bashkuar UÇK-së të datës qershor 1999 të nënshkruar nga W04752.<sup>257</sup>

118. Trupi Gjykses konstaton se U009-9397-U009-9403 dhe SITF00333313-00333313 kanë lidhje me aspektet në vijim: (i) organizimin, strukturën, dhe zinxhirin komandues të UÇK-së (dhe elementet shoqëruese të përkufizimit të konfliktit të armatosur); (ii) kompetencat e UÇK-së për të zbatuar masa disiplinore; dhe (iii) përpjekjet për të rekrutuar forca për Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, dhe zbatimin e politikës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në lidhje me këtë.<sup>258</sup>

---

<sup>254</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>255</sup> Shtojca 6.2.3 e Përgjigjes, f. 1-2; Shtojca 6.1. e Përgjigjes, f. 86-87

<sup>256</sup> U009-9397-U009-9403; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 17.

<sup>257</sup> SITF00333313-00333313; *shih* Shtojcën 6 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 430.

<sup>258</sup> Aktakuza e Ndryshuar, para. 15, 18-19.

119. Duke iu kthyer autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të U009-9397-U009-9403 dhe SITF00333313-00333313.<sup>259</sup> Materialet që përfshihen në U009-9397-U009-9403 kanë datë, numra dokumentesh, mbajnë stemën e UÇK-së, ose vulën e UÇK-së, dhe janë të nënshkruara. SITF00333313-00333313 ka datën “06.1999”, ka stemën e UÇK-së dhe nënshkrimin e përpiluesit.

120. Trupi Gjykses është bindur se U009-9397-U009-9403 dhe SITF00333313-00333313 kanë vlerë provuese *prima facie*. Ekzistojnë tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë për arsyet e shtjelluara në paragrafët paraprakë dhe materialet kanë lidhje me aspekte për të cilat ka mospajtime siç është emërimi i komandantëve dhe pushteti dhe kompetencat e UÇK-së për aspekte disiplinore. Gjithashtu, dokumentet që përshihen në U009-9397-U009-9403 mbështesin njëri tjetrin, që e shton edhe më tej vlerën provuese *prima facie* të këtij materiali.

121. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 120 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Mbrojtja do të jetë në gjendje të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës.

122. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses pranon si prova U009-9397-U009-9403 dhe SITF00333313-00333313.

## 6. Kategoria 6: Dokumentet e proceseve ligjore shtetërore dhe ndërkombëtare

123. ZPS-ja kërkon pranimin e pesë materialeve që përbëhen nga deklarata të dëshmitarëve, dosje të çështjeve dhe raporte të proceseve ligjore shtetërore dhe ndërkombëtare.<sup>260</sup> ZPS-ja parashtron se këto dokumente kanë lidhje me lëndën,

---

<sup>259</sup> Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 17, 430.

<sup>260</sup> U003-6888-U003-6903, SPOE00125979-00126002, IT-03-66 P208, IT-03-66 P110, 0188-3494-0188-3591 RED; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 44, 366, 517, 522, 647.

janë autentike dhe kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk dëmton Mbrojtjen.<sup>261</sup>

124. Mbrojtja kundërshton pranimin e këtyre materialeve duke argumentuar se ZPS-ja nuk ka saktësuar relevancën e disa materialeve, materialet duhet të paraqiten përmes dëshmitarëve përkatës të ZPS-së, dhe se ato burojnë prej Serbisë.<sup>262</sup> Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton konkretisht pranimin e: (i) IT-03-66 P208 sepse asnjë prej personave të renditur në të nuk paraqitet në Aktakuzën e Ndryshuar;<sup>263</sup> (ii) U003-6888-U003-6903 dhe SPOE00125979-00126002, për shkak të natyrës dëshmuese të këtyre materialeve, duhet të jenë objekt i rregullave 153-155.<sup>264</sup>

125. Trupi Gjykues gjykon se dokumentet përfshijnë: (i) dy versione të një deklarate dëshmitari të TPNJ-së të Xhudi Tomas me datë 28-30 gusht 2003 në lidhje me zhvarrimin e viktimave të pretenduara të një ekzekutimi në Malet e Berishës;<sup>265</sup> (ii) procesverbalin e dëshmisë së Hoze Barajbar në gjykimin *Selim Krasniqi dhe të tjerët* në Gjykatën e Qarkut në Prizren ku konfirmohet raporti i tij mjekoligjor në lidhje me zhvarrimin, ekzaminimin dhe identifikimin e kufomës së viktimës së përmendur me emër në Aktakuzën e Ndryshuar;<sup>266</sup> (iii) një raport penal i autoriteteve serbe në lidhje rrëmbimin nga UÇK-ja të personave serbë në Caralevë, afër Shtimes, më 29 qershor 1998;<sup>267</sup> dhe (iv) një dosje të çështjes penale me numër "A/V-004" në lidhje me krimet e kryera në Likoc, i cili përmban një grumbull të dokumenteve, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve.<sup>268</sup>

---

<sup>261</sup> Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.

<sup>262</sup> Shtojca 6.7 e Përgjigjes, f. 2-3; Shtojca 6.9 e Përgjigjes, f. 4. Shtojca 6.11 e Përgjigjes, f. 11-12.

<sup>263</sup> Shtojca 6.9 e Përgjigjes, f. 4.

<sup>264</sup> Shtojca 6.7 e Përgjigjes, f. 2-3.

<sup>265</sup> U003-6888-U003-6903, IT-03-66 P110; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 44, 522. Trupi Gjykues vë në dukje se U003-6888-U003-6903 është i paredaktuar pa prova materiale dhe se IT-03-66 P110 është i paredaktuar, por me prova materiale.

<sup>266</sup> SPOE00125979-00126002; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 366.

<sup>267</sup> IT-03-66 P208; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 517.

<sup>268</sup> 0188-3494-0188-3591 RED; Shtojca 6 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 647.

126. Trupi Gjykues vë në dukje se U003-6888-U003-6903, IT-03-66 P110, SPOE00125979-00126002, dhe 0188-3494-0188-3591 RED përbëjnë, ose përfshijnë, deklaratat ose shënime të intervistave të përgatitura për qëllime të procedurave ligjore, të paraqitura që shkak të vërtetësisë së përmbajtjes së tyre dhe, si të tilla, janë objekt i rregullave 153-155.<sup>269</sup> Nëse ZPS-ja dëshiron t'i paraqesë ato, duhet ta bëjë këtë në pajtim me rregullat 153-155. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do t'i pranojë këto materiale si prova jогоjore.

127. Trupi Gjykues konstaton se IT-03-66 P208, raport i autoriteteve serbe për rrëmbimin e personave serbë nga UÇK-ja në Caralevë, afër Shtimes, më 29 qershor 1998, është relevant sepse ofron prova në lidhje me rrëmbimin e katër serbëve. Siç është vënë në dukje më lart, ky incident nuk përfshihet në Aktakuzën e Ndryshuar në mënyrë të pavarur. Megjithatë, ky incident mund të ofrojë prova për sulmet e pretenduara të përhapura gjerësisht ose sistematike kundër popullatës civile dhe praktikave të sjelljes që janë të rëndësishme për konstatimet që duhet të nxjerrë Trupi Gjykues. Trupi Gjykues gjithashtu është bindur për autenticitetin *prima facie* dhe vlerën provuese të këtij materiali në lidhje me aspektet e përmendura më lart. Trupi Gjykues vë në dukje se burimi i dokumenteve është qartësisht i dukshëm. Trupi Gjykues gjithashtu është bindur se vlera provuese *prima facie* e këtij dokumenti nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve.

128. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues pranon IT-03-66 P208 dhe refuzon, në mënyrë jo të prerë, pranimin e U003-6888-U003-6903, IT-03-66 P110, SPOE00125979-00126002, dhe 0188-3494-0188-3591 RED si prova jогоjore.

---

<sup>269</sup> F01631, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Pranimin e Provave që lidhen me Dëshminë e W04748-ës*, 30 qershor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F01631/RED); ICTY, *Prosecutor v. Milošević*, IT-02-54-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Admissibility of Prosecution Investigator's Evidence](#), 30 September 2002, para. 18; *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Appeal concerning Rule 92bis\(C\)](#), 7 June 2002, para. 31; *Prosecutor v. Milošević*, IT-02-54-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for the Admission of Evidence-in-Chief of Its Witnesses in Writing](#), 16 April 2003, p. 2.

## C. VLERËSIMI I PESHËS SË DOKUMENTEVE TË PRANUARA

129. Trupi Gjykses vë në dukje se të gjitha materialet e propozuara për të cilat ka konstatuar në këtë vendim se janë të pranueshme përmbushin kriteret për pranim sipas rregullës 138(1). Megjithatë, pranimi nuk është njëlloj me vendimin se çfarë peshe Trupi Gjykses do t'u japë këtyre provave. Dhe as përcaktimi i vlerës provuese *prima facie* nga Trupi Gjykses nuk është njëlloj me konstatimin e vlerës provuese të provave, që Trupi Gjykses do ta bëjë në fund të gjykimit. Në pajtim me rregullën 139(2), Trupi Gjykses duhet të vlerësojë secilën provë duke pasur parasysh të gjitha provat e pranuar në tërësi para gjykimit, dhe të bëjë vlerësim tërësor dhe peshim të provave për të përcaktuar nëse janë vërtetuar faktet nën shqyrtim. Rrjedhimisht, edhe pse Trupi Gjykses ka konstatuar në këtë vendim se materialet janë të pranueshme, në fund do të vlerësojë se çfarë peshe do t'u japë këtyre materialeve duke pasur parasysh tërësinë e provave të pranuar në gjykim. Konfirmimi me prova të tjera dhe/ose dhënia e kontekstit nga dëshmitari për provat materiale të pranuar do të jetë faktor mjaftë i rëndësishëm gjatë vlerësimit nga Trupi Gjykses se çfarë peshe dhe vlere provuese do t'u jepet provave të pranuar.

## VI. VENDIM

130. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore në lidhje me Shtojcën 6.
- b) **PRANON** si prova IT-03-66 P34, 106389-01 prej 00:00 deri 01:12 dhe prej 01:27 deri 02:00, 077571-01, 061427-30, 061427-17, 061427-16, 061427-11, 061427-05, 061427-04, 055928-01, 054010-03 prej 00:05:08 deri 35:54, 011795-06 prej 00:00:01 deri 00:04:54 dhe prej 00:05:08 deri 00:15:00, SITF00245022-SITF00245096, 076891-076903, SPOE40000795-40000795,

- SPOE40010567-40010569, SITF00243000-00243003, 020396-020396, 021049-021056, 034159-034159, 034162-034162A, 043853-043854, 043863-043863, IT-03-66 P46, IT-03-66 P111, IT-03-66 P112, IT-03-66 P209, SITF00143980-00143983, SITF00189121-00189140 RED2, SPOE00073399-00073428, SPOE00068624-00068634, SPOE0006077-00060785, SPOE00060952-00060954, SPOE00233700-00233701, SPOE00233999-00234000, SPOE00061164-00061168, SPOE00060777-00060785, U007-9551-U007-9600, U007-9607-U007-9661 f. U007-9607 deri U007-9617 dhe U007-9621 deri U007-9661, U008-6010-U008-6033, U008-9781-U008-9974, 034163-034165, 102870-102875, U017-3162-U017-3162, U001-1387-U001-1387, U001-1383-U001-1383, U000-7803-U000-7803, U000-7734-U000-7734, U000-5385-U000-5385, U000-4400-U000-4400, U000-0529-U000-0529, SITF40001762-40001763, SITF00242605-00242605, SITF00242603-00242603, SITF00242583-00242583, IT-05-87\_1 P00441, SITF00069017-SITF00069017, IT-05-87 P02461, U017-3364-U017-3364, U001-7342-U001-7342, U001-4904-U001-4913, U001-7059-U001-7061, U000-6413-U000-6413, U000-0410-U000-0444, SITF00009608-SITF00009610, U002-3460-U002-3492, U002-0163-U002-0208, U001-1918-U001-1918, U001-1916-U001-1916, U001-1912-U001-1912, U001-1531-U001-1531, U001-1381-U001-1381, U000-6954-U000-6978, SITF00244612-00244656, U009-1995-U009-1995, U009-1663-U009-1676, U001-5808-U001-5808, U001-5245-U001-5245, U001-1094-U001-1094, U009-9397-U009-9403, SITF00333313-00333313, dhe IT-03-66 P208;
- c) **REFUZON**, në mënyrë jo të prerë, pranimin e U003-2456-U003-2458, U002-4992-U002-4995, SITF00245017-00245111, SPOE00113615-00113639, SPOE00072818-SPOE00072818, SPOE00072817-SPOE00072817, SPOE00072816-SPOE00072816, SPOE00072810-SPOE00072810, IT-03-66 P1.9, 058755-058755, SPOE00128614-SPOE00128614, SPOE00128617-

SPOE00128631, SPOE00128632-SPOE00128637, SPOE00128640-  
SPOE00128647, SPOE00128649-SPOE00128660, SPOE00128665-  
SPOE00128669, SPOE00128670-SPOE00128677, SPOE00128684-  
SPOE00128693, SPOE00128699-SPOE00128700, SPOE00128702-  
SPOE00128703, SPOE00128740-SPOE00128743, SPOE00128746-  
SPOE00128751, SPOE00128754-SPOE00128755, SPOE00128758-  
SPOE00128767, SPOE00128770-SPOE00128776, SPOE00128778-  
SPOE00128785, SPOE00128785-SPOE00128850, SPOE00128903-  
SPOE00128914, SPOE00128927-SPOE00128929, f. SPOE00209321-  
SPOE00209328 dhe SPOE00209333-SPOE00209428 të SPOE00209321-  
00209428, 036622-036837, 043900-044239, 099794-099797, 099786-099788,  
IT-03-66 P47, U016-3286-U016-3287, SPOE00059723-00059725,  
SPOE00060865-00060865, SPOE00109507-00109518, U003-6888-U003-  
6903, IT-03-66 P110, SPOE00125979-00126002, dhe 0188-3494-0188-3591  
RED;

- d) **URDHËRON** Administratoren që të caktojë numra provash materiale për materialet e pranuar, dhe për të gjitha përkthimet e këtyre materialeve; dhe
- e) **URDHËRON** ZPS-në që të dorëzojë kërkesa për ruajtjen e konfidencialitetit të cilitdo material të pranuar, deri më **12 dhjetor 2023, ora 16:00**. Çdo përgjigje ndaj tyre të dorëzohet deri më **19 dhjetor 2023, ora 16:00**. Kundërpërgjigjet nuk do të merren parasysh.

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E martë, 5 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.

Shënim shpjegues:

Në paragrafin 41, "SPOE40010567-400105679" u zëvendësua me "SPOE40010567-40010567".

Në paragrafin 130(b), është shtuar një referencë për SITF00245022-SITF00245096.